



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

RAPORTI VJETOR

2008

Prishtinë
mars 2009

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta, dhe efçente të ujit dhe mbeturinave për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrotjen e shëndetit publik.”

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	3
1. PARATHËNIE	5
2. HYRJE	7
2.1. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË SEKTORËT E UJIT DHE MBETURINAVE.....	7
2.2. REFORMAT E PASLUFTËS NË SEKTORËT E UJIT DHE MBETURINAVE.....	11
3. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM.....	16
3.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM.....	16
3.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM	16
3.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM	17
3.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM	18
4. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUM	20
4.1. LICENCIMI	20
4.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS.....	22
4.3. PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT	29
4.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE	33
5. AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL.....	34
5.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV DHE TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM	34
5.2. STATUSI FINANCIAR I ZRRUM	36
5.3. MBËSHTETJA FINANCIARE NGA DONATORËT.....	37
6. RELACIONET E JASHTME	38
6.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË.....	38
6.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EUROPË.....	39
6.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN	40

7.	SFIDAT DHE PERSPEKTIVA PËR VITIN 2009	42
7.1.	PROBLEMET ME TË CILAT ËSHTË PËRBALLUR ZRRUM NË 2008	42
7.2.	SYNIMET STRATEGJIKE TË ZRRUM NË VITIN 2009	44
8.	ASPEKTET FINANCIAR	45
8.1.	SHPENZIMET	45
8.2.	MBËSHTETJA NGA DONATORËT	47
8.3.	TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT	47
8.4.	ASETET E ZRRUM	48

1. Parathënie

Kam kënaqësinë e veçantë që, për herë të parë prej themelimit të Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) në nëntor të vitit 2004, të raportoj te Kuvendi i Kosovës për punën dhe aktivitetin e ZRRUM gjatë vitit 2008.

Në fakt, deri me aprovimin dhe dekretimin në qershor të vitit 2008 të *Ligjit Nr. 03/L-086 Mbi Ndryshimin e Rregullores 2004/49 Për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave*, ZRRUM ka qenë përgjegjësi e UNMIK-ut dhe i ka dhënë llogari Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të KB. Me aprovimin e këtij Ligji përgjegjësia e ZRRUM është transferuar nga UNMIK/PSSP tek Kuvendi i Kosovës, dhe në frymën e këtij transferimi të përgjegjësisë, unë kam nderin të prezantoj para juve zhvillimet dhe të arriturat e ZRRUM gjatë vitit 2008, edhe pse dorëzimi i raportit vjetor të ZRRUM te Kuvendi i Kosovës nuk është përcaktuar në mënyrë specifike me Ligjin Nr. 03/L-086.

Duke pasur parasysh natyrën e monopolit që kanë shërbimet e ujësjellësit dhe (aktualisht edhe) shërbimet e mbeturinave, roli i ZRRUM është esencial në parandalimin e keqpërdorimit potencial të këtij monopoli si dhe në stimulimin e efikasitetit ekonomik dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për konsumatorët e këtyre shërbimeve. Këtë rol ZRRUM e ushtron duke shfrytëzuar mekanizmat rregullator, që ka në pajtim me ligjin, si dhe në pajtim me synimet strategjike dhe parimet me të cilat udhëhiqet në përmbushjen e misionit të vet.

Në vitin 2008, financimi i aktiviteteve të ZRRUM është bërë prej Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK), përkundër faktit se ZRRUM ka vazhduar të arkëtojë taksat e licencimit nga kompanitë e licencuara të cilat të hyra do të duhej të shërbenin si burim për financimin e veprimtarisë së ZRRUM në pajtim me Rregulloren 2004/49 dhe në pajtim me parimet e pavarësisë financiare të rregullatorëve të pavarur si parakusht fundamental për pavarësinë rregullatore. Si zhvillim pozitiv në këtë drejtim, në fund të vitit 2008, Buxheti i ZRRUM për 2009 për herë të parë është shqyrtuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës (Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financë), duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm në drejtim të funksionalizimit praktik të pavarësisë financiare të ZRRUM në vitin 2009 dhe në të ardhmen. Financimi i ZRRUM prej të hyrave që realizohen nga taksat e licencimit, e shkarkon barrën nga taksapaguesit dhe e bartë tek shfrytëzuesit e shërbimeve të ZRRUM.

Me kënaqësi mund të konstatoj se në vitin 2008 ZRRUM i ka përmbushur të gjitha përgjegjësitë e veta ligjore si dhe synimet operative të përcaktuara me Planin e Punës për 2008. Përpos angazhimit të personelit të ZRRUM, për arritjen e objektivave të parapara ZRRUM ka qenë i mbështetur edhe nga konsulenca ndërkombëtare e financuar nga donatorët (AER-i dhe SCO).

Gjatë vitit 2008, ZRRUM ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

- (i) **përforcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme** me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe kredibilitetit të procesit rregullator;
- (ii) **avansimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës** së kompanive të ujit dhe mbeturinave me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve;
- (iii) **Avansimi i procesit tarifar** me qëllim të ngritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave;

- (iv) **Bashkëpunimi me palët e interesit** me qëllim krijimit të një kornize ligjore dhe institucionale efektive që mundëson veprim të harmonizuar dhe inkluziv në krijimin e sektorëve të qëndrueshëm të ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Në planin institucional dhe të organizimit të brendshëm, ZRRUM ka bashkëpunuar ngushtë me palët e interesit për amendamentimin e Rregullores 2004/49 dhe zëvendësimin e saj me Ligj të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Poashtu, gjatë këtij viti ZRRUM ka amendamentuar një pjesë të legjislacionit sekondar (Rregullat e ZRRUM), si dhe ka nxjerrë disa akte të rëndësishme për funksionimin e tij si: Kodi i Punës, Strategjia e Komunkimit, dhe Procedurat e Brendshme Administrative dhe të Sigurimit të Kualitetit. Ridizajnimi i web-faqes ka qenë një tjetër aktivitet i ZRRUM i ndërmarrë në vitin 2008 në funksion të përforsimit institucional dhe ngritjen e transparencës.

Një rëndësi të veçantë në vitin 2008 ZRRUM i ka kushtuar edhe avansimit të mëtutjeshëm të sistemit të vlerësimit të performancës për kompanitë që i rregullon. Në këtë kuadër, në qershor 2008, ZRRUM ka publikuar dhe shpërndarë raportin vjetor të performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2007, në të cilin raport është dhënë një përmbledhje e zhvillimeve në sektorët e ujit dhe mbeturinave në Kosovë si dhe janë analizuar treguesit financiar, operativ dhe të nivelit të shërbimeve të 16 ndërmarrjeve publike që i rregullon ZRRUM. Për më tepër, me qëllim të nxitjes së konkurrencës ndërmjet këtyre ndërmarrjeve, ZRRUM ka shpallur dhe ka ndarë çmimet për kompanitë me performancën më të mirë.

Avansimit të procesit tarifor, që është padyshim boshti kurrizor i rregullativës ekonomike, ZRRUM i ka kushtuar një pjesë të madhe të angazhimit të tij në vitin 2008. Përpos që ka hartuar metodologjinë e re tarifore, ZRRUM ka zhvilluar një proces të gjatë dhe gjithëpërfshirës tarifor për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit. Ky proces është përmbyllur në fund të vitit 2008 me aprovimin e tarifave të reja për afat 3-vjeçar. ZRRUM konsideron që tarifat e reja të aprovuara së bashku me investimet kapitale që pritet të ndërmirren nga kompanitë e ujit dhe donatorët, janë një hap i rëndësishëm në ngritjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanive të ujit dhe rrjedhimisht në ngritjen e cilësisë dhe sigurisë së këtyre shërbimeve në interes të popullatës dhe zhvillimit ekonomiko-social të Kosovës.

ZRRUM gjatë vitit 2008 ka vazhduar bashkëpunimin me të gjitha palët e interesit në Kosovë, në veçanti me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH), Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF), me SHUKOS-in (Shoqatën e ndërmarrjeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit), Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), Agjencinë për Integritet Europian si dhe me donatorët. Në planin e bashkëpunimit me rregullatorët e ujit të vendeve tjera, ZRRUM gjatë vitit 2008 ka intensifikuar bashkëpunimin e frytshëm me rregullatorët ekonomik të ujit të Shqipërisë, Skotlandës dhe Portugalisë.

Sigurisht se në fokus të angazhimeve të ZRRUM edhe në vitin 2008 ka vazhduar të jetë mbrojtja e interesave të konsumatorëve. Aktivitetet që ka ndërmarrë ZRRUM në këtë plan (publikimi dhe shpërndarja e broshurave, ndërmarrja e hulumtimit të opinionit të konsumatorëve, zgjidhja e ankesave përmes KKK-ve, organizimi i workshopeve me kompanitë për avansimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve etj.) kanë ndikuar në vetëdijësimin më të madh konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe për krijimin nga ana e kompanive të një qasjeje më të fokusuar kah konsumatorët.

Afrim Lajçi
Drejtor i ZRRUM

2. Hyrje

2.1. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË SEKTORËT E UJIT DHE MBETURINAVE

Struktura institucionale si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante në sektorët e ujit dhe mbeturinave në Kosovë janë përcaktuar në legjislacionin që është në fuqi. Institucionet kryesore dhe përgjegjësitë e tyre respektive në sektorin e ujërave dhe të mbeturinave janë si vijon:

(i) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)

MMPH është institucion udhëheqës në sektorin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë që ka përgjegjësi të hartojë politikat sektorale dhe strategjitë. Me Ligjin për Ujërat (nr. 2004/24) rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me administrimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësinë e institucioneve në fushën e ujërave dhe resurseve ujore si dhe përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e MMPH dhe institucioneve tjera në fushën e ujërave. Sipas këtij ligji MMPH është përgjegjëse për hartimin e politikave për sektorin e ujërave si dhe për hartimin e planit strategjik për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë. Poashtu sipas këtij ligji MMPH është autoritet kompetent për lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e ujërave si dhe për shkarkimin e ujërave të zeza. Në sektorin e mbeturinave roli dhe përgjegjësitë e MMPH janë përcaktuar me Ligjin për Mbeturinat.

(ii) Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM)

ZRRUM është themeluar me Ligjin për Rregullimin e Veprimtarisë së Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave (nr. 03/L-086) i cili ligj përcakton kornizën ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë dhe përcakton përgjegjësitë dhe autorizimet e ZRRUM si rregullator i pavarur që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. ZRRUM, sipas këtij ligji, është autoritet përgjegjës për: (i) licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave, (ii) përcaktimin (aprovimin) e tarifave për shërbimet e ujit dhe mbeturinave, (iii) përcaktimin dhe mbikqyrjen e standardeve të shërbimit, (iv) monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve, dhe (v) rregullimin e raporteve ndërmjet ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve.

(iii) Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF)

MEF në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (nr. 03/L-087) përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim mbikqyrë afarizmin e ndërmarrjeve publike të cilat janë pronësi e Republikës së Kosovës si dhe përkujdeset për operimin e përgjegjshëm dhe transparent të tyre. Ky ligj themelon kornizën për ushtrimin e të drejtës pronësore në ndërmarrjet publike dhe rregullon qeverisjen korporative të këtyre ndërmarrjeve.

(iv) Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP)

IKSHP është autoritet përgjegjës për përcaktimin e standardeve të cilat duhet ti plotësojë uji i pijes që distribuohet nga ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe poashtu monitoron

zbatimin e këtyre standardeve. Baza ligjore për autoritetin dhe përgjegjësitë e IKSHP mbështetet në Udhëzimin Administrativ (nr. 2/99) me të cilin rregullohet problematika e cilësisë së ujit të pijes.

(v) Komunitat

Sipas Ligjit për Vetqeverisjen Lokale në Kosovë (nr. 03/L-040), komunitat janë kompetente për ofrimin e shërbimeve publike të furnizimit me ujë dhe të mbeturinave. Kjo kompetencë e tyre në rastin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit duhet të realizohet përmes Marrëveshjeve të Shërbimit që nënshkruajnë komunitat me kompanitë përkatëse regjionale që ofrojnë shërbimet e veta në komunën respektive.

HARMONIZIMI I LEGJISLACIONIT DHE QARTËSIMI PËRGJEGJËSIVE INSTITUCIONALE

a) Sektori i Mbeturinave

Ligji për Mbeturinat (nr. 02/L-030) përcakton se MMPH është autoritet përgjegjës për licencimin e personave juridik që menaxhojnë mbeturinat. Kjo bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit licencimi i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM. Komunitat në anën tjetër sipas Ligjit për Mbeturina janë përgjegjëse për administrimin e mbeturinave në territorin e vet dhe për përcaktimin e tarifave për shërbimet e mbeturinave. Edhe kjo përgjegjësi e komunave bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM.

Këto kundërthënie janë eliminuar në një masë me Rregulloren 2006/31 me të cilën është dekretuar Ligji për Mbeturinat dhe e cila e ka konfirmuar përgjegjësinë e ZRRUM për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave. Megjithatë, është e nevojshme që të harmonizohen këto dy Ligje me qëllim të evitimit të paqartësive sa i përket rolit dhe përgjegjësisë institucionale në sektorin e mbeturinave.

Përderisa nuk ndodhë ky harmonizim, ZRRUM e zbaton përgjegjësinë e vet në bazë të Ligjit nr. 03/L-086 për licencimin e kompanive publike të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave si dhe për përcaktimin e tarifave për kompanitë publike të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave.

b) Sektori i Shërbimeve të Ujit

ZRRUM konsideron se ka nevojë të shqyrtohet poashtu edhe çështja e përgjegjësisë së komunave në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit (e përcaktuar me Ligjin për Vetqeverisjen Lokale), meqenëse në praktikë kjo përgjegjësi është vështirë e aplikueshme duke pasur parasysh se Republika e Kosovës është pronare e asetëve të ndërmarrjeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Në vijim, janë paraqitur në mënyrë skematike rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse në sektorin e ujit (figurën 1) dhe në sektorin e mbeturinave (Figurën 2).

Figura 1: Paraqitja Skematike e Institucioneve Përgjegjëse në Sektorin e Ujit





Figura 2: Paraqitja Skematike e Institucioneve Përgjegjëse në Sektorin e Mbeturinave



2.2. REFORMAT E PASLUFTËS NË SEKTORËT E UJIT DHE MBETURINAVE

Duke pasur parasysh rolin vital që kanë shërbimet publike të ujësjellësit dhe mbeturinave për popullatën, sektori i shërbimeve të ujit dhe ai i mbeturinave në Kosovë kanë qenë, pas vitit 1999, në fokus të angazhimeve të institucioneve kosovare, administratës së UNMIK-ut dhe komunitetit të donatorëve.

Kështu pas fazës emergjente të viteve 1999-2001, në vitin 2002 UNMIK në bashkëpunim me insitucionet kosovare ka inicuar një proces të reformimit gjithëpërfshirës të sektorit të shërbimeve të ujit dhe sektorit të mbeturinave.

Ky reformim ka pasur për synim përfundimtarë krijimin e sektorëve të qëndrueshëm të ujit dhe mbeturinave në mënyrë që të përmirësohet shkalla e mbulueshmërisë me këto shërbime si dhe të ngritet cilësia e shërbimeve.

Shtyllat kryesore të reformave të ndërmarra në sektorët e ujit dhe mbeturinave kanë konsistuar në sa vijon:

(i) Konsolidimi (Regjionalizimi) i Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) si insitucion përgjegjës për mbikqyrjen e menaxhimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë, në vitin 2003 ka filluar implementimin e procesit të ristrukturimit (konsolidimit) të ndërmarrjeve publike komunale të ujit dhe mbeturinave. Me këtë proces, i cili është finalizuar në fund të vitit 2006, nga 35 ndërmarrje komunale (shumica prej të cilave kanë ofruar praktikisht të gjitha shërbimet komunale) janë krijuar **7 ndërmarrje publike regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit** si dhe **7 ndërmarrje respektive të mbeturinave**. Ndërmarrjet komunale në komunat me shumicë serbe, për shkaqe politike, nuk kanë participuar dhe nuk janë përfshirë me këtë proces.

Motivi kryesor për regjionalizimin e ndërmarrjeve komunale ka qenë krijimi i ndërmarrjeve të qëndrueshme financiarisht përmes:

- Shfrytëzimit të potencialit që ofron ekonomia e shkallës
- Zbatimit efektiv të mbikqyrjes rregullatore dhe menaxheriale
- Përgatitjes për reformim të mëtejme me Participimin e Sektorit Privat (PSP)
- Parandalimit të ndërhyrjes politike në menaxhmentin e ndërmarrjeve publike

Përkundër rezistencave që ka pasur për procesin e konsolidimit nga disa prej komunave, procesi është përmbyllur në fund të vitit 2006. Efektet pozitive të këtij procesi janë evidente, dhe ato kryesisht konsistojnë në: eliminimin e strukturës së fragmentarizuar, ngritjen e llogaridhënies dhe transperencës, dhe ngritjen e efijencës.

Duhet të theksohet këtu se, përpos komunave me popullatë shumicë serbe të cilat nuk janë përfshirë me procesin e konsolidimit, së voni edhe disa komuna tjera kanë ndërmarrë veprime të cilat janë demonstrim i drejtëpërdrejtë i kundërshtimit të procesit të konsolidimit. Kështu, komuna e Deçanit në vitin 2007 me një vendim të Asamblesë Komunale ka vendosur të mos jetë më pjesë e kompanisë regjionale të ujit dhe asaj të mbeturinave dhe ka themeluar ndërmarrjen publike komunale. Njësoj ka vepruar edhe komuna e Vitisë me shërbimet e mbeturinave në vitin 2008. Ligjshmëria e këtyre vendimeve është e kontestueshme dhe në një të ardhme të afërt ky veprim duhet të shqyrtohet nga Qeveria e Kosovës dhe të ri-shikohet nga komunat e Decanit dhe Vitisë.

Figura 3: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjetës dhe Kanalizimit



RWaterC Prishtina	RWaterC Hidroregjioni Jugor	RWaterC Hidrodrini	RWaterC Ujësjetësi Regional	RWaterC Radoniqi	RWaterC Bifurkacioni	RWaterC Hidromorava	Municipalities that are not provided with water service
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliqi -Lipjani -Shtimja -Glogovci	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Istogu -Klina -Juniku	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtrria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novobërda -Zubin Potoku -Leposaviq -Shtërpca -Deqani

Figura 4: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Grumbullimit të Mbeturinave



KRM Pastrimi	KRM Ekoregjioni	KRM Ambienti	KRM Uniteti	KRM Çabrat	KRM Pastërtia	KRM Higjiena	Komunat jashtë shërbimeve nga KRM-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliqi -Lipjani -Glogovci	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi -Rahoveci	-Peja -Klina -Deçani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtrria	-Gjakova	-Ferizaj -Kaçaniku -Shtimja	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novobërda -Zubin Potoku -Leposaviq -Shtërpca -Istogu

(ii) Ndarja e Administrimit të Resurseve Ujore nga Shërbimet e Ujit

Përgjegjësia për menaxhimin e resurseve ujore i takon Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH) e cila poashtu ka përgjegjësi të hartojë politikat dhe strategjinë për administrimin e ujërave në Kosovë. Ndërkaq, përgjegjësia për shërbimet e ujit u takon 7 kompanive regjionale publike të ujësjellësit dhe kanalizimit;

(iii) Krijimi i Legjislacionit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave

Rregullimi i sektorit të ujit në Kosovë bëhet nga 3 autoritet rregullatore:

- **ZRRUM**, si rregullator i pavarur ekonomik, që ka përgjegjësi licencimin, përcaktimin e tarifave, dhe mbikqyrjen e performancës së kompanive regjionale të ujit,
- **MMPH**, si rregullator mjedisor, që ka përgjegjësi dhënien e lejeve ujore për shfrytëzim të ndryshëm si dhe dhënien e lejeve për shkarkimin e ujërave të zeza (kanalizimit), dhe
- **IKSHP**, si rregullator i cilësisë së ujit, që ka përgjegjësi të përcaktojë dhe mbikqyrë standardet e kualitetit të ujit të pijes që distribuohet nga kompanitë regjionale të ujësjellësit;

(iv) Themelimi i Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës – KLMC

Me qëllim të menaxhimit më efikas dhe më eficient të deponive sanitare të cilat pas luftës janë ndërtuar me financimin e donatorëve (lexo: AER-it) është themeluar Kompania për Menaxhimin e Deponive–KLMC Sh.A. e cila menaxhon deponitë regjionale përmes operatorëve privat të cilët kontraktohen në bazë të tenderit të hapur. Kjo është bërë me qëllim të ndarjes së funksioneve në menaxhimin e mbeturinave, me ç'rast kompanitë regjionale janë përgjegjëse për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave ndërkohë funksioni i menaxhimit të deponive i është transferuar KLMC-së si kompani qendrore

(v) Korporatizimi i Ndërmarrjeve Regjionale të Ujit dhe Mbeturinave

Ky proces është kompletuar në vitin 2007 dhe si rezultat ka pasur transformimin e ndërmarrjeve publike në shoqëri aksionare (SH.A) të cilat kanë një identitet të qartë ligjor dhe financiar dhe të cilat administrohen sipas parimeve të qeverisjes korporative. Çështja e pronësisë së këtyre ndërmarrjeve është rregulluar me Ligjin për Ndërmarrjet Publike (i miratuar me 13 qershor 2008). Sipas këtij Ligji në pronësi të Republikës së Kosovës janë të ashtuquajturat ndërmarrje publike qendrore ku bëjnë pjesë:

- Gjashtë¹ nga shtatë ndërmarrjet publike regjionale që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Ndërmarrja hidroekonomike “Ibër-Lepenci” që furnizon ujë me shumicë (ujë të patrajtuar) për disa ndërmarrje të ujësjellësit dhe për industrinë e rëndë, dhe poashtu menaxhon sistemin e ujitjes që mbulohet nga ky hidrosistem;

¹ Ndërmarrja e shtatë regjionale e ujësjellësit dhe kanalizimit - “Bifurkacioni Sh.A. e regjionit të Ferizajt - sipas këtij Ligji është radhitur në listën e ndërmarrjeve publike komunale pronare e të cilës janë komuna e Ferizajt dhe komuna e Kaçanikut. Ky klasifikim i kësaj ndërmarrje do të duhej rishikuar dhe kjo kompani të radhitet në listën e ndërmarrjeve publike qendrore sikurse edhe gjashtë ndërmarrjet tjera të ujësjellësit me qëllim të ruajtjes së strukturës konsistente të lidhur me statusin e njëjtë ligjor të të gjitha ndërmarrjeve të ujësjellësit.

- Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KLMC) e cila menaxhon deponitë sanitare ku deponohen mbeturinat e ngurta nga ndërmarrjet regjionale të mbeturinave.

Komunat në anën tjetër, sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, janë pronare të aseteve të 7 ndërmarrjeve publike regjionale të mbeturinave të cilat ofrojnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në territorin e Kosovës. Pronësia e komunave dhe rrjedhimisht fuqia vendimarrëse e komunave përkatëse për një kompani regjionale bazohet në përqindjen e konusmatorëve që ka komuna respektive në kuadër të regjionit ku ofrohen shërbimet nga ndërmarrja regjionale.

3. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUM

3.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator ekonomik i sektorëve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë i themeluar më 26 Nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK 2004/49](#) në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 Qershor 2008 duke transferuar kështu përgjegjësitë për rregullimin e sektorëve të ujit dhe mbeturinave nga UNMIK tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUM është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- [Përcaktimi i tarifave](#) që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;
- [Dhënia e licencave](#) për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave;
- [Mbrotja e interesave të konsumatorëve](#) duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit;
- [Monitorimi dhe raportimi i performancës](#) së ofruesve të shërbimeve;
- [Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shkyçje](#) individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;
- [Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve](#) dhe mbështetja e punës së tyre;
- [Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve të vjetra.](#)

Pra, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë iu ofrojnë konsumatorëve shërbime eficiente dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086 si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorët e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekondar (në formën e 14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të amendamentuar kohëpaskohe.

3.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM

Parimet me të cilat udhëhiqet ZRRUM në punën e vet, për ti përmbushur misionin dhe synimet strategjike, janë:

- **Pavarësia:** Ekzekutimi me profesionalizëm por në mënyrë të pavarur i mandatit rregullator dhe përgjegjësiave ligjore në interes qytetarëve të Kosovës;

- **Balancimi:** Përcaktimi i tarifave të balancuara të shërbimit të cilat u mundësojnë kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave që të ofrojnë shërbimet në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante, por të cilat poashtu marrin parasysh mundësitë paguese të popullatës.
- **Objektiviteti:** Monitorimi efektiv si dhe vlerësimi objektiv dhe transparent i punës së kompanive të licencuara duke bërë krahasime të duhura në baza vjetore për performancën e tyre;
- **Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve:** Trajtimi i kontesteve dhe ankesave të konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë dhe duke involvuar kompanitë e licencuara në këtë proces;
- **Konsultimi:** Konsultimi me palët e interesit për të siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e tyre përmes shkëmbimit të informatave, memorandumëve të bashkëpunimit, mbajtjes së workshopeve të hapura, publikimit të raporteve relevante në web-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve. Jo më pak e rëndësishme është edhe ofrimi i këshillave Qeverisë për hartimin dhe rishikimin e politikave;
- **Transparenca:** Publikimi i informatave në mënyrë të hapur dhe transparente për tu mundësuar të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUM-i;
- **Bashkëpunimi:** Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit dhe në veqanti me rregullatorët tjerë të sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë (siq janë MMPH dhe IKSHPK) për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë. Poashtu, ky parim i referohet edhe bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në regjion dhe në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira;
- **Mos-diskriminimi:** Sigurimi se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët janë të drejta dhe nuk bëjnë diskriminim apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve.

3.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM


Në përputhje me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore.

Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit sipas të cilës departamentet e ZRRUM i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore, Seksioni i Performansës, dhe Seksioni për Ligj dhe Licenca, ndërsa përgjegjës për mbështetjen e biznesit të ZRRUM-it është Seksioni për Administratë dhe Financa.

Struktura organizative e ZRRUM është dhënë në [Figurën 5](#) në vijim:

Figura 5: Organogrami i ZRRUM



3.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM

(i) Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Seksioni përfshijnë:

- zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit;
- zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit;
- udhëheqjen e procesit tarifor në frymën dispozitave ligjore në fuqi;
- shqyrtimin dhe evaluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara;
- auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM-it.

(ii) Seksioni i Monitorimit të Performansës

Roli i Seksionit të Monitorimit të Performansës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara të ZRRUM-it dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky Seksion ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore lidhur me performansën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Poashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të Seksionit të Monitorimit të Performansës përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shqyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

(iii) Seksioni për Ligj dhe Licencim

Seksioni për Ligj dhe Licencim i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it në lidhje me aktivitetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrit, dhe gjykatave të Kosovës.

Ky Seksion poashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM.

(iv) Seksioni i Administratës dhe Financave të ZRRUM

Seksioni i Administratës dhe Financave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Seksion ofron mbështetje administrative, gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Poashtu ky Seksion menaxhon prokurimin, procesin e buxhetimit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin administrativ dhe automjetet e ZRRUM-it.

4. Aktivitetet Rregullatore të ZRRUM

4.1. LICENCIMI

Në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK 2004/49 dhe me Ligjin Nr. 03/L-086 që ka amendamentuar këtë Rregullore, ZRRUM ka licencuar kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, si dhe shërbimet e deponimit të mbeturinave. Rrjedhimisht, ZRRUM ka licencuar 16 kompani publike që ofrojnë shërbimet e përmendura:

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, ZRRUM ka licencuar kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit si vijon:

1. **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komuntat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliqi, Podujevë, Lipjan, Shtimje, dhe Drenas;
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A**, që ofron shërbimet në komuntat: Prizren, Malishevë, Suharekë, dhe Dragash;
3. **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komuntat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe komuna e Deçanit²;
4. **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komuntat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtri;
5. **KRU “Hidrosistemi Radoniqi” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komuntat³: Gjakovë, Rahovec;
6. **KRU “Hidromorava” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komuntat: Gjiçan, Kamenicë, dhe Viti;
7. **KRU “Bifurkacioni” Sh.A.³**, që ofron shërbimet në komuntat: Ferizaj dhe Kaçanik.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komuntat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUM.

² Komuna e Deçanit ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini”, derisa me një vendim të Kuvendit Komunal i Deçanit të vitit 2007 ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë regjionale “Hidrodrini” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim i KK Deçan konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK Deçan dhe kthimin e kësaj komune nën autoritetin e KRU “Hidrodrini”.

³ KRU “Bifurkacioni” Sh.A., ka mbetur kompania e vetme regjionale e ujësjellësit dhe kanalizimit (me përjashtim të komunave me popullatë shumicë serbe të cilat nuk janë përfshirë fare në procesin e restrukturimit dhe korporatizimit) që është klasifikuar si ndërmarrje publike komunale në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Kjo ka ndodhë duke u bazuar në parimin që duhet të ofrohen shërbimet në 3 ose më tepër komuna për të qenë ndërmarrje qendrore publike.

Licencat e këtyre shtatë kompanive regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit janë në fuqi deri më 31 tetor 2009.

(ii) Kompania e Licencuara për Furnizim të Ujit me Shumicë

Furnizimi i ujit me shumicë me Rregulloren 2004/49 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

1. **“Ibër-Lepenci” Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe për KRU “Prishtina” Sh.A.

Licenca e “Ibër –Lepencit” është valide deri më 31 tetor 2009.

(iii) Kompanitë e Licencuara për Shërbimie e Grumbullimit të Mbeturinave

1. **KRM “Pastrimi” Sh.A.** që ofron shërbimet për komunitat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Lipjan, Podujevë, ..
2. **KRM “Ekoregjioni” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunitat: Prizren, Suharekë, Malishevë, dhe Shar;
3. **KRM “Ambienti” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunitat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan⁴;
4. **KRM “Uniteti” Sh.A.** që ofron shërbimet e veta në komunitat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtri;
5. **KRM “Çabrati” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunitat: Gjakovë dhe Rahovec;
6. **KRM “Higjiena” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunitat: Gjiçan, Kamenicë, dhe Viti⁵;
7. **KRM “Pastërtia” Sh.A.** që ofron shërbimet në komunitat: Ferizaj dhe Kaçanik.

Licencat e kompanive regjionale të mbeturinave janë valide deri më 31 nëntor 2009.

(iv) Kompanitë e Licencuara për Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave

1. **Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë – KLMC Sh.A.**⁶ që menaxhon deponitë: në Prishtinë, Podujevë, Gjiçan, Prizren, dhe Stacionin e Transferit në Ferizaj;
2. **KRM “Ambienti” Sh.A.** që menaxhon deponinë regjionale të Pejës; dhe
3. **KRM “Uniteti” Sh.A.** që menaxhon deponinë regjionale të Mitrovicës.

⁴ Situata e njëjtë sikurse tek shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është edhe tek shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sa i përket komunës së Deçanit.

⁵ Kuvendi Komunal i Vitisë ka marrë poashtu vendim (në vitin 2008) që most ë jetë pjesë e KRM “Higjiena” dhe ka krijuar ndërmarrjen e veçantë për shërbimet e mbeturinave, që poashtu bie në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

⁶ KLMC ka qenë e paraparë të menaxhojë të gjitha deponitë sanitare regjionale në Kosovë. Megjithatë duke pasur parasysh se deponitë regjionale në Pejë dhe Mitrovicë janë ndërtuar para se të promovohet koncepti i menaxhimit të të gjitha deponive sanitare në Kosovë nga KLMC dhe poashtu faktin se deponitë regjionale të Pejës dhe Mitrovicës janë pronë e komunave përkatëse, çështja e transferit të këtyre dy deponive tek KLMC nuk është zgjidhur ende dhe për rrjedhojë këto dy deponi aktualisht menaxhohen nga ndërmarrjet regjionale të mbeturinave të regjionit të Pejës, respektivisht Mitrovicës.

4.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS

ZRRUM monitoron performansën e kompanive publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave. Monitorimi i performansës bëhet në bazë të raporteve të cilat i dorëzojnë këto ndërmarrje tek ZRRUM duke u bazuar në sistemin e raportimit të krijuar nga ZRRUM i quajtur OFCR/ROFK.

Përpos monitorimit, ZRRUM bën edhe vlerësimin e performansës së kompanive të ujit dhe mbeturinave, bazuar në Indikatorët Kyç të Perofmansës (IKP) dhe raporton publikisht për performancën e tyre në formën e Raportit Vjetor të Perfomansës. Me qëllim të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga kompanitë e licencuara, ZRRUM bën auditimin e të dhënave dhe procedurave në bazë të të cilave gjenerohen të dhënat nga kompanitë. Procesi i auditimit kryhet gjatë periudhës janar-prill të vitit pasues, kështuqë të dhënat e raportuara për performancën e kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2008 janë duke u audituar aktualisht. Megjithatë, në vazhdim është dhënë në formë të përmbledhur performanca operative, financiare dhe e shërbimeve ndaj konsumatorëve për kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave në bazë të licencës së lëshuar nga ZRRUM, sipas të dhënave të raportuara nga ato dhe të pa-audituar nga ZRRUM.

4.2.1. Performansa e Sektorit të Ujit

Performansa e shtatë kompanive regjionale të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit, në vitin 2008 ka treguar përmirësim krahasuar me vitin 2007. Edhe përkundër kësaj, ZRRUM konsideron se performansa e këtyre kompanive ende nuk ka mbërritur nivelin e kënaqshëm.

Gjatë vitit 2008, shumica e kompanive kanë qenë në kufij të qëndrueshmërisë financiare, kryesisht si rezultat i shkallës së ulët të arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara, si dhe mos faturimit të një sasive të konsiderueshme të ujit të prodhuar (humbjet teknike dhe administrative të ujit).

(a) Humbjet e Ujit (Uji i Pafaturuar)

Ujin e Pafaturuar (UPF) e përbëjnë humbjet fizike (përmes rrjedhjeve nga tubacionet) dhe humbjet komerciale (nga gabimet në leximin e ujëmatësve, faurimi paushall, lidhjet ilegale, etj.).


Në vitin 2008, UPF si mesatare e sektorit ka qenë **56%**, duke **shënuar një përmirësim prej 2% krahasuar me 2007**.

Shkalla e lartë e humbjeve të ujit mbetet si një prej fushave më problematike në performansën e kompanive të ujit. Me këtë shkallë të lartë të humbjeve cenohet esencialisht qëndrueshëria financiare e kompanive. Prandaj ZRRUM kërkon nga kompanitë e ujit që reduktimin e humbjeve të ujit ta trajtojnë si prioritet kryesor të tyrin dhe rrjedhimisht të ndërmarrin të gjitha veprimet e mundshme për reduktimin e tyre në një masë të arësyeshme.

Si zhvillim pozitiv në drejtim të uljes së shkallës së humbjeve duhet të theksohet se gjatë vitit 2008 disa prej kompanive kanë filluar me implementimin e strategjisë për zvogëlimin e UPF.

Nga grafikoni (Figura 5), vërehet se në vitin 2008 nivelin më të lartë të UPF e ka shënuar KRU 'Hidrodrini' Pejë, me 75%.

Figura 5: Humbjet e Ujit - UPF



(b) Kualiteti i Ujit


ZRRUM ka përgjegjësi që të sigurohet se kualitetit i ujit që iu ofrohet konsumatorëve nga kompanitë e licencuara të ujësjetlesit të jetë në pajtim me standardet që janë në fuqi në Kosovë. Ndërkaq, përcaktimin e standardeve dhe monitorimin e kualitetit të ujit e bën IKSHPK.

Tabela 1 paraqet përqindjen e testeve të kualitetit të ujit që nuk i kanë plotësuar standardet bakteriologjike, fizike dhe kimike të kualitetit të ujit të pijshëm në 2008 dhe përmirësimet në kualitetin e ujit krahasuar me 2007 (nga 3.2% në 3.0% të mostrave të cilat nuk plotësojnë standardet). Të dhënat e paraqitura në këtë tabelë janë të bazuara nga raportet e IKSHPK.

Tabela 1: Përqindja e testeve të dështuara të kualitetit të ujit

Kompania Regjionale e Ujësjetlesit dhe Kanalizimit	Kualiteti i ujit (%)	
	2007	2008
KUR 'PRISHTINA' (Prishtinë)	1.4%	1.2%
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' (Prizren)	7.4%	4.8%
KUR 'HIDRODRINI' (Pejë)	6.0%	6.8%
KUR 'BIFURKACIONI' (Ferizaj)	4.4%	8.3%
KUR 'MITROVICA' (Mitrovicë)	3.4%	2.6%
KUR 'RADONIQI' (Gjakovë)	0.1%	0.3%
KUR 'HIDROMORAVA' Gjilan	2.8%	1.2%
Mesatarja e Sektorit	3.2%	3.0%

Figura 6: Kualiteti i Ujit




(c) Shkalla e Arkëtimit

Shkalla e arkëtimit, në nivel të sektorit të ujit është ngritur prej 61% në 2007 në 66% në 2008. Siç mund të vërehet nga grafikoni mëposhtë, të gjitha kompanitë veç e veç kanë treguar trende pozitive të zhvillimit të këtij treguesi.

Përmirësimin më të dukshëm prej vitit 2007 në 2008 e ka shënuar KRU 'Hidrodrini' Pejë me ngritje të shkallës së arkëtimit për 14%.

Figura 6: Shkalla e Arkëtimit të Kompanive Regjionale të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



Me të hyrat e arkëtuara gjatë vitit 2008 kompanitë kanë qenë në gjendje të mbulojnë shpenzimet operative.

ZRRUM konsideron se për ngritjen e mëturjes së shkallës së arkëtimit, përpos angazhimit më të madh të menaxhmentit të kompanive, është e nevojshme edhe mbështetje nga institucionet relevante në kuptim të sundimit të ligjit dhe subvencionimit të pagesës për rastet sociale.

(c) Norma e Mbulimit të Punës dhe Kostoja për Njësi


Norma e mbulimit të punës prej 1.05, si një tregues që demonstroi aftësinë e kompanive për të mbuluar shpenzimet operative nga të hyrat e arkëtuara, konsiderohet e ulët. Ndërsa mos-arkëtimi prej 34% i mjeteve të gatshme ka bërë që kompanitë të mos jenë në gjendje të sigurojnë investimet e nevojshme në rehabilitimin e sistemeve si dhe në zgjerimin e kapaciteteve.

Pothuajse pjesa dërmuese e investimeve kapitale janë realizuar nga mjetet e donatorëve.

Në vitin 2008 **kostoja për njësi ka qenë €0.10**, që krahasuar me 2007, demonstroi një rritje prej €0.01 për njësi, në nivel të sektorit. Rritja e kostos operative mund t'i atribuohet kryesisht rritjes së kostos së energjisë prej 2% si dhe asaj të mirëmbajtjes prej 1%.

Në nivel të sektorit, pjesëmarrja e secilës kategori të kostove në shumën totale të kostove operative mund të vërehet në grafikonin vijues (Figura 7). Siç shihet, në tërësinë e kostove të kompanive pjesën kryesore e përbëjnë pagat dhe energjia.

Figura 7: Struktura e Kostove të Kompanive Regjionale të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



4.2.2. Performansa e Sektorit të Mbeturinave

(i) Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

Në 2008 krahasuar me 2007, performansa e shtatë kompanive regjionale të cilat ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave, në fushën operative ka treguar përmirësim, ndërsa në fushën financiare ka treguar përkeqësim.

Vlerësimi është bërë duke u bazuar në treguesit kryesor të performansës, të përlogaritur nga të dhënat që i kanë raportuar kompanitë.


Gjatë vitit 2008, te gjitha kompanite kanë qenë nën kufirin e qëndrueshmërisë financiare, kryesisht si rezultat i shkallës së ulët të arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara.

Në 2008 krahasuar me 2007, në nivel të sektorit paraqitet kryesisht rritje e efijencës në grumbullimin e mbeturinave. Kjo rritje kryesisht ka ardhur si rezultat i zvogëlimit të numrit të punëtorëve, përkundër rritjes jo aq të theksuar të sasisë së mbeturinave. Ndërsa, rënia e efijencës së stafit në grumbullimin e mbeturinave tek disa kompani mund të interpretohet edhe përmes pjesëmarrjes së operatorëve privat në grumbullimin e mbeturinave në regjionin ku veprojnë kompanitë.

Në përgjithësi, mesatarja e mbeturinave të mbledhura për punëtor në vitin 2008 ka qenë 171 ton, që është për 15 ton më e lartë se në vitin 2007.

Gjatë vitit 2008, në mesatare të sektorit, rreth 86% e mbeturinave të grumbulluara janë deponuar në deponitë e licencuara, ndërsa pjesa tjetër e mbetur hedhen në fushëhedhurinat komunale. Edhe mëtej regjioni i Gjakovës mbetet pa deponi të licencuar, kështu që Çabrati, Gjakovë të tërë sasinë e mbeturinave e ka hedhur në fushëhedhurina, të cilat janë jashtë çdo standardi ambiental.


Figura 8: Efijenca e Stafit të Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave



Në përgjithësi në nivel të sektorit të grumbullimit të mbeturinave, shkalla e arkëtimit në vitin 2008 është 58% që është me e ulët se ajo e vitit 2007 për 13%. Nga grafikoni vërehet se uljen më të lartë të arkëtimit e ka shënuar KRM 'Pastrimi' dhe KRM 'Eko-Regjioni'.

Ky nivel i shkallës së arkëtimit nuk ju mundëson kompanive të mbulojnë koston operative. Kjo dukuri pastaj reflektohet edhe në nivelin e ulët të mirëmbajtjes së aseteve dhe përkeqësimin e nivelit të shërbimeve nga kompanitë publike. ZRRUM konsideron se shkalla faktike e arkëtimit është edhe më e ulët pasi që disa prej kompanive i faturonjë disa kategori të konsumatorëve (sidomos bizneset) në momentin kur të bëhet realizimi i të hyrave nga këta konsumatorë.

Figura 9: Shkalla e Arkëtimit të Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave




Në nivel të sektorit, **norma e mbulimit të punës prej 0.83**, konsiderohet nga ZRRUM si shumë të ulët, meqë kjo demonstroi se kompanitë nuk janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

Në vitin 2008, **kostoja për njësi ka qenë €34.24**, ku krahasuar me 2007, në nivel të sektorit, është treguar zvogëlim prej €2.00 për njësi (ton i mbeturinave të grumbulluara). Zvogëlimi i koston operative mund t'i atribuohet kryesisht zvogëlimit të të gjitha kategorive të kostove.

Pjesëmarrja e secilës kategori të kostove në shumën totale të kostove operative si mesatare e kompanive regjionale të mbeturinave mund të shihet në Figurën 10.

Figura 10: Struktura e Kostove Operativetë Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave



(ii) Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave

Menaxhimi i deponive sanitare në Kosovë bëhet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovë-KLMC Sh.A. Shumica e konsumatorëve të KLMC (por jo të gjithë) janë kompanitë regjionale të grumbullimit të mbeturinave për zonat e shërbimit në Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Podujevë dhe Prizren dhe një numër i operatorëve privat ndërkombëtar dhe vendor.

Dy nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, KRM 'Uniteti' Mitrovicë si dhe KRM 'Ambienti' Pejë janë të licencuara për menaxhimin e deponive regjionale në këto dy qytete d.m.th. jashtë menaxhimit të KLMC. Ndërkaq, KRM 'Çabrat' Gjakovë vazhdon të deponojë mbeturinat në deponi të palicencuara.

Vlerësimi i performancës së KLMC është bërë duke u bazuar në treguesit kryesor të performancës, të përlogaritur nga të dhënat e pranuar nga kjo kompani.

Gjatë vitit 2008 rreth 180.682 ton mbeturina janë deponuar në tërë deponitë e menaxhuara nga KLMC, sasi kjo që është për 20% më e madhe se sa në vitin 2007. Përkundër kësaj rritje dhe rritjes së faturimit, shkalla e arkëtimit në 2008 ka pësuar rënie për 7% krahasuar me 2007.

PROBLEMET NË MENAXHIMIN E DEPONIVE SANITARE

Shkalla e ulët e arkëtimit prej 83% i ka bërë të pamundur KLMC-së që të mbulojë kostot e operimit. Kjo ka pasur për pasojë menaxhimin e dobët të deponive sanitare, jashtë të gjitha standardeve mjedisore, duke rrezikuar kështu seriozisht shëndetin publik si dhe mjedisin.

Menaxhimi i dobët i deponive sanitare nga ana e KLMC-së është konstatuar nga inspektorët e ZRRUM si dhe nga inspektorët e MMPH-së.

Përpjekjet e bëra nga ZRRUM në vitin 2008 për të adresuar problemin e menaxhimit të dobët të deponive, në bashkëpunim me institucionet relevante (MMPH, MEF, përfaqësuesit e komunave dhe përfaqësuesit e kompanive të mbeturinave), kanë qenë të pasuksesshme.

Ofrimi i mbështetjes institucionale për KLMC-në, e qoftë në formën e sigurimit të mekanizmave për arkëtimin e faturave nga kompanitë e mbeturinave, apo në formën e sigurimit të granteve apo huasë qeveritare për KLMC-në, është i domosdoshëm për të siguruar menaxhim të deponive sanitare sipas standardeve të përcaktuara.

Problemet financiare të funksionimit të KLMC-së duhet të trajtohen si çështje e prioritetit të lartë nga Qeveria e Kosovës për të mundësuar menaxhimin efektiv të deponive sanitare.

4.3. PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMIT

4.3.1. Tarifat e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me mandatin ligjor që ka, ZRRUM në vitin 2008 ka zhvilluar procesin tarifor për aprovimin e tarifave për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për shtatë kompanitë regjionale të licencuara që ofrojnë këto shërbime. Si rezultat i këtij procesi janë aprovuar tarifatat e reja të shërbimit të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2009 dhe janë të aplikueshme për periudhën e ardhshme trevjeçare (2009-2011).

Përcaktimit të tarifave të reja i ka paraprirë një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës që është zhvilluar gjatë gjithë vitit 2008, në të cilin proces janë analizuar parametrat operativ dhe financiar të shtatë kompanive regjionale publike të ujësjellësit të parashtuara në kërkesat e tyre tarifore.

Procesi tarifor është zhvilluar duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe politikat tarifore të cilat i ka adoptuar ZRRUM në bashkëpunim me palët tjera të interesit në vitin 2007.

(i) Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave

E veçanta e këtij procesi është aplikimi i një metodologjie më e avansuar në krahasim me vitet e mëparshme, metodologji kjo e cila është zhvilluar në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtar të cilët e kanë mbështetur ZRRUM në kuadër të projektit të AER-it. Kjo metodologji është diskutuar dhe sqaruar për kompanitë e ujësjellësit dhe kanalizimit (në 3 workshope dhe shumë takime individuale që janë mbajtur për këtë qëllim). Karakteristikat kryesore të kësaj metodologjie tarifore janë:

- Aprovimi i tarifave afatgjata (3-vjeçare) për dallim nga proceset e mëparshme kur tarifatat janë aprovuar për afat 1-vjeçar;
- Marrja parasysh e llogaritjes së shkallës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore;
- Aplikimi i Normës së Kthimit në Kapital sipas përvojave të vendeve me ekonomi të tregut të hapur dhe atyre të BE-së;
- Aplikimi i Kontabilitetit Rregullator;
- Përcaktimin e ndarë të kostove për shërbimet e ujësjellësit nga kosot për shërbimet e kanalizimit.

(ii) Përgatitja dhe Zhvillimi i Procesit Tarifor

Për zbatimin me sukses të procesit tarifor sipas metodologjisë së re, ZRRUM ka zhvilluar përgatitjet e nevojshme të cilat kanë konsistuar në:

- Amendamentimin e Rregullës Tarifore për Shërbimet e Ujit (ZRRUM R-02/UeK);
- Përgatitjen e modelit tarifor dhe softuerëve për kalkulimin e tarifave;
- Nxjerrjen e politikave tarifore në bashkëpunim me palët tjera të interesit;
- Hartimin e udhëzuesve për kalkulimin e tarifave nga ana e kompanive;
- Trajnimin e stafit të kompanive për përgatitjen e aplikacioneve tarifore;
- Përcaktimin e kalendarit tarifor me aktivitete specifike për secilën fazë të procesit.

(iii) Tarifatat e Aprovuara

Tarifatat e reja kanë shënuar një ngritje krahasuar me tarifatat e mëparshme. Kjo ngritje e tarifave është vlerësuar si absolutisht e domosdoshme për t'iu mundësuar kompanive gjenerimin e të hyrave të nevojshme për mbulimin e kostove të tyre dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve. Poashtu, kjo ngritje e tarifave është e para në tri vitet

e fundit (tarifat e ujit janë ngritur për herë të fundit në fillim të vitit 2006) edhe pse në ndërkohë janë ngritur çmimet e mallërave tjera dhe tarifat e energjisë elektrike të cilat kanë ndikim të dretjepërdrejtë dhe të konsiderueshëm në koston e ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Pasqyra e tarifave të aprovuara është dhënë e përmbledhur në tabelën vijuese (Tabela2).

Tabela 2: Tarifat e aprovuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit: 2009-2011

Kompania Regjionale	Kategoria e tarifave	Njësia	Tarifa për Kons. Shtëpiak			Tarifa për Kons. Jo-shtëpiak		
			2009	2010	2011	2009	2010	2011
KUR 'PRISHTINA' Prishtinë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.30	0.32	0.34	0.72	0.76	0.81
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.03	0.04	0.04	0.07	0.09	0.10
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.36	0.38	0.79	0.85	0.91
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.22	0.24	0.27	0.46	0.51	0.57
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.04	0.04	0.04	0.05	0.08	0.08
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.26	0.28	0.31	0.54	0.59	0.65
KUR 'HIDRODRINI' Pejë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.17	0.18	0.19	0.41	0.42	0.43
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.07	0.08	0.09
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.22	0.23	0.24	0.48	0.50	0.52
KUR 'RADONIQI' Gjakovë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.27	0.28	0.29	0.57	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.11	0.11	0.11
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.32	0.33	0.34	0.68	0.73	0.75
KUR 'MITROVICA' Mitrovicë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.25	0.27	0.28	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.09	0.10	0.11	0.14	0.15	0.18
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.34	0.37	0.39	0.74	0.77	0.82
KUR 'HIDROMORAVA' Gjilan	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.30	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.07	0.07	0.07	0.10	0.11	0.12
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.35	0.36	0.37	0.70	0.73	0.76
KUR 'BIFURKACIONI' Ferizaj	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.29	0.70	0.72	0.73
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.06	0.13	0.13	0.15
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.34	0.35	0.83	0.85	0.88

Siç mund të shihet nga Tabela 3, tarifat fikse kanë mbetur të pandryshuara (1,0 EUR/muaj për konsumatorët shtëpiak, dhe 3.0 EUR/muaj për konsumatorët komercial dhe institucional), ndërsa tarifat volumetrike janë ngritur në mënyrë të shkallëzuar për periudhën e ardhshme trivjeqare. Ngritja e tarifave volumetrike është bërë në një masë relativisht të vogël dhe ka marrë parasysh rrethanat ekonomiko-sociale në Kosovë respektivisht mundësitë paguese të familjeve kosovare.

Konkretisht, për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak tarifat volumetrike (për sasinë e ujit të konsumuar) janë ngritur si vijon:

- Ngritja më e madhe është aprovuar për kompaninë regjionale të ujësjellësit Hidromorava-Gjilan në lartësi 16.6 %, ndërsa ngritja më vogël për kompaninë regjionale të ujësjellësit Hidrodrini-Pejë në masën 4.7%.
- Për vitin 2010 ngritja është edhe më e vogël dhe sillet në kufinjtë 2.8% (në rastin e kompanisë regjionale Hidromorava-Gjilan) deri në 9% (për kompaninë regjionale Prishtina);
- Për vitin 2011 është aprovuar një ngritje e ngjajshme me vitin 2010 që sillet prej 2.8% (në rastin e kompanisë regjionale Hidromorava-Gjilan) deri në 10.7 % (në rastin e kompanisë regjionale Hidroregjioni-Prizren).

4.3.2. Investimet e Planifikuara në Sektorin e Ujësjellësit dhe Kanalizimit gjatë Periudhës së Ardhshme 3-vjeçare

Është me rëndësi të theksohet se me aprovimin e tarifave të reja janë parapa të ndërmirren investime të konsiderueshme nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit në vlerë totale prej mbi 140 milion EUR, investime këto që janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të cilat do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorët. Realizimin e këtyre investimeve ZRRUM do ta monitorojë ngushtë.

Siç mund të shihet në Tabelën 3, pjesa më e madhe e investimeve kapitale pritet të financohen nga donacionet dhe grantet. Megjithatë, vlera prej mbi 23 milion EUR që planifikohet të investohen nga të hyrat vetjake të kompanive është një hap i rëndësishëm që demonstroi rritjen graduale të kapaciteteve financuese të kompanive të ujësjellësit.

Tabela 3: Investimet Kapitale të Planifikuara nga Kompanitë e Ujësjellësit: 2009-2011

Nr.	Kompanitë Regjionale të Ujit (KUR)	Investimet 2009-2011		Gjithsejt
		Vetanake	Grante	
1	'PRISHTINA' Prishtinë	9,217,000 €	67,980,300 €	77,197,300 €
2	'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	2,023,900 €	34,566,100 €	36,590,000 €
3	'HIDRODRINI' Pejë	3,751,600 €	1,290,000 €	5,041,600 €
4	'RADONIQI' Gjakovë	2,493,800 €	9,261,000 €	11,754,800 €
5	'MITROVICA' Mitrovicë	1,971,700 €	1,569,540 €	3,541,240 €
6	'HIDROMORAVA' Gjilan	1,126,600 €	1,620,000 €	2,746,600 €
7	'BIFURKACIONI' Ferizaj	2,450,500 €	1,575,000 €	4,025,500 €
Investimet totale në sektor:		23,035,100 €	117,861,940 €	140,897,040 €

PÛRCAKTIMI I CAQEVE TË PERFORMANSËS PËR KOMPANITË E UJËSJELLËSIT

Bashkë me aprovimin e tarifave të reja, ZRRUM ka përcaktuar objektiva shumë sfidues për kompanitë e ujësjellësit në funksion të përmirësimit të performancës së tyre operative dhe financiare gjatë periudhës së ardhshme trivjeqare. Kjo para së gjithash ka të bëjë me ngritjen e shkallës së inkasimit (nga 60% sa është aktualisht në 80% në fund të vitit 2011) dhe në reduktimin e humbjeve të ujit (nga 56% sa janë aktualisht në rreth 40% në fund të vitit 2011).

ZRRUM do ta monitorojë për së afërmi arritjen nga ana e kompanive të caqeve të përcaktuara, dhe do të ndërmarrë masa adekuata në kuadër të autorizimeve të veta në rast të mospërbushjes së tyre.

ZRRUM beson fuqishëm se aprovimi i tarifave të reja, i përcjellur me përcaktimin e objektivave ambicioze dhe me stimulimin e investimeve kapitale, në afat të gjatë është në interes të konsumatorëve dhe në funksion të mbrojtjes së interesave të tyre. Kjo për faktin se aprovimi i tarifave adekuate është mënyra e vetme për ngritjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanive të ujësjellësit që është parakusht fundamental për shërbime cilësore dhe të sigurt të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Procesi i aprovimit të tarifave të reja është zhvilluar në konsultim të ngushtë me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ashtu siq parashihet me ligj. Këto Komisione janë trupa të themeluar në 7 regjionet e Kosovës ku ofrojnë shërbimet e veta kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të njëjtat përbëhen nga përfaqësuesit e të gjitha komunave të Kosovës të cilët përfaqësojnë interesat e të gjitha kategorive të konsumatorëve.

4.3.3. Përcaktimi i Tarifave për Shërbimet e Mbeturinave

Tarifat për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave për shtatë kompanitë regjionale të mbeturinave të cilat kanë qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2008, janë vazhduar deri më 31 maj 2009. Kjo është bërë me qëllim të koordinimit të procesit të aprovimit të këtyre tarifave me procesin e aprovimit të tarifave për deponimin e mbeturinave. ZRRUM ka vlerësuar si të domosdoshme harmonizimin e këtyre dy kategorive të tarifave (për shërbimet e grumbullimit dhe shërbimet e deponimit të mbeturinave) dhe rrjedhimisht në pjesën e parë të vitit 2009 do ti zhvillojë këto procese paralelisht.

4.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

4.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Me qëllim të përmirësimit të standardeve të shërbimeve ndaj konsumatorëve, nga ana e ZRRUM-it janë ndërmarrë aktivitete të gjithanshme si: organizimi i punëtorive dhe debateve me kompanitë dhe palët e tjera të interesit ku janë diskutuar dhe janë bartë përvojat më të mira ndërmjet kompanive, dhënia e rekomandimeve për kompanitë e ujit dhe kërkimi i zotimeve specifike nga to për përmbushjen dhe përmirësim të ndjeshëm të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, në pothuajse të gjitha kompanitë e ujit janë themeluar zyra për relacione me konsumatorë. Këto zyra janë pajisur me personel dhe infrastrukturë të nevojshme për trajtimin efikas të ankesave të konsumatorëve. Rrjedhimisht, në vitin 2008 kompanitë e ujit dhe mbeturinave kanë qenë me azhure në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve në pajtim me standardet minimale të shërbimit të përcaktuara me rregullat e ZRRUM-it. Poashtu, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), ZRRUM në vazhdimësi ka përcjellur cilësinë e ujit të pijes dhe me kohë ka reaguar kur ka pasur dështime të cilësisë së ujit.

4.4.2. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve përmes KKK-ve

ZRRUM-i edhe këtë vit ka vazhduar të ju ofrojë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), mbështetje të gjithanshme si organizative ashtu dhe logjistike me qëllim që të ngritët profili dhe efektiviteti i tyre

KKK në secilën prej zonave të shërbimit të kompanive rajonale janë takuar në baza mujore, gjatë këtyre takimeve janë shqyrtuar dhe zgjidhur një numër i konsiderueshëm i ankesave të konsumatorëve si dhe janë shqyrtuar konteste të ndryshme në mes konsumatorëve dhe kompanive përkatëse.

Gjatë vitit 2008 janë mbajtur 82 takime të rregullta të KKK ku përveç pikave të ndryshme në interes për konsumatorët janë shqyrtuar dhe zgjidhur gjithësejt 21 ankesa të parashtruara nga konsumatorët, shumica e këtyre ankesave (20), janë nga kategoria e konsumatorëve të amvisërisë.

Për të krijuar një pasqyrë më reale lidhur me nivelin e kënaqëshmërisë së konsumatorëve me shërbimet publike të ujësjellësit dhe mbeturinave dhe lidhur me tarifat e shërbimeve, ZRRUM-i me përkrahjen e KKK-ve ka realizuar një sondazh me qytetar në nivel të Kosovës me ç'rast janë anketuar 1200 respondent. Rezultatet e këtij sondazhi janë përmbledhur në një raport përmbledhës.

Në anën tjetër, me qëllim të ngritjes së profilit të KKK-ve dhe njëkohësisht edhe njohuritë e konsumatorëve për të drejtat e tyre, ZRRUM-i ka përgatitur dhe ka publikuar në tri gjuhët zyrtare në një numër të konsiderueshëm (mbi 100.000) fletëpalosje të cilat përmbajnë informacione të dobishme për konsumatorët në lidhje me parashtrimin e ankesave. Fletëpalosjet janë shpërndarë tek konsumatorët nga kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit.

5. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV DHE TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM

(i) Amendamenti i Legjislacionit Primar

Deri në aprovimin e Ligjit mbi *Ndryshimin e Rregullores së UNMIK 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe Mbeturinave* (Ligji Nr. 03/L-086) më datë 13 qershor 2008, ZRRUM ka funksionuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 dhe i ka dhënë llogari për punën e vet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara. Me aprovimin e këtij ligji, përgjegjësia e ZRRUM është transferuar nga UNMIK/PSSP tek Kuvendi i Kosovës.

Themelimi dhe funksionimi i ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator bazohet në nenin 19.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërkaq bazën ligjore për veprimtarinë e ZRRUM si rregullator ekonomik i veprimtarisë së ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave e paraqet Ligji Nr. 03/L-086.

Meqenësë Ligji Nr. 03/L-086 nuk e ka ndryshuar përmbajtjen e Rregullores 2004/49, përpos që ka transferuar përgjegjësitë nga UNMIK-u te Kuvendi i Kosovës, ZRRUM, në vitin 2007/2008, ka inicuar amendamentimin e këtij ligji. Kjo iniciativë është filluar me qëllim të harmonizimit të këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi dhe me qëllim të definimit më të mirë të disa aspekteve të cilat janë evidentuar si problematike gjatë këtyre viteve të zbatimit të tij. Konkretisht, arësyet për amendamentimin e Ligjit Nr.03/L-086 respektivisht Rregullores 2004/49, janë:

- Harmonizimi i këtij Ligji me Ligjin për Mbeturina⁷
- Ndryshimi i strukturës qeverisëse të ZRRUM që aktualisht është përmes Drejtorit dhe Zv.Drejtorit me një strukturë të Bordit⁸
- Përcaktimi më i qartë i obligimeve raportuese të ZRRUM ndaj Kuvendit të Kosovës në njërën anë, dhe i obligimeve raportuese të kompanive të ujësjellësit ndaj ZRRUM në anën tjetër
- Definimi më i saktë i statusit financiar të ZRRUM si autoritet që financohet nga taksat e licencimit të cilat i paguajnë ndërmarrjet publike të licencuara
- Rishikimi i disa dispozitave që kanë të bëjnë me tarifat dhe me rregullimin e borxheve të vjetra

⁷ Sipas Ligjit për Mbeturina, MMPH është përgjegjëse për licencimin e ofruesve të shërbimeve të mbeturinave ndërkaq komunat janë përgjegjëse për përcaktimin e tarifave. Në naën tjetër të dy këto funksione (edhe licencimi edhe përcaktimi i tarifave) sipas Ligjit Nr.03/L-086 janë e ZRRUM. Kjo kundërthënie është tejkaluar aktualisht me Rregulloren e UNMIK 2006/31 e cila e ka dekretuar Ligjin për Mbeturina dhe e cila ia atribuon ZRRUM përgjegjësinë për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave (duke përfshi edhe licencimin dhe përcaktimin e tarifave). Megjithatë, amendamenti i Ligjit Nr.03/L-086 dhe heqja e kompetencave të ZRRUM në sektorin e mbeturinave përpos që do ti eliminonte paqartësitë ligjore, poashtu do të mundësonte edhe futjen e konkurrencës në ofrimin e këtyre shërbimeve.

⁸ Të gjitha agjencitë dhe autoritetet rregullatore të pavarura në Kosovë (përpos ZRRUM) qeverisen prej një organi kolegjial –Bordit. Prandaj, ky përfashtim do të duhej riparuar, dhe rrjedhimisht edhe për ZRRUM të parashihet krijimi i Bordit si organ që mbikqyrë punën e menaxhmentit dhe merr vendime rregullatore. Për hir të një qasje konsistentecës në

ZRRUM, duke qenë koshient për rëndësinë e amendamenteve të mësipërme, do të angazhohet në bashkëpunim me institucionet tjera (Kuvendin e Kosovës, MMPH, MEF, MAPL, Asociacionin e komunave dhe OEK) që kjo punë të kryhet gjatë vitit 2009.

(ii) Amendamenti i Legjislacionit Sekundar – Rregullat e ZRRUM

Në janar të vitit 2005, ZRRUM ka nxjerrë 14 akte nënligjore (Rregulla) në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2004/49 të cilat Rregulla më detajisht i rregullojnë aspektet e caktuara që janë në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësi të tij si: licencimi, tarifat, standardet e shërbimit, karta e konsumatorëve, shkyçja etj.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 03/L-086, ZRRUM ka filluar procesin e amendamentimit të këtij legjislacioni sekundar (Rregullave). Rrjedhimisht, gjatë periudhës korrik-dhjetor 2008 ka amendamentuar Rregullat për Licencim dhe Rregullat për Tarifa. Amendamenti i këtyre Rregullave përpos që reflekton ndryshimet e legjislacionit primar (amendamentimin e Rregullores 2004/49 me Ligjin Nr. 03/L-086) ka përfshi edhe disa ndryshime të cilat pasqyrojnë ndryshimet e metodologjisë tarifore, si dhe evitimin e disa mangësive të cilat janë identifikuar gjatë periudhës 3-vjeçare të zbatimit të këtyre Rregullave.

(iii) Hartimi i Rregulloreve të Brendshme Administrative dhe Rregullatore

Në vitin 2008, ZRRUM ka përpiluar dhe ka nxjerrë disa dokumente dhe rregullore të rëndësishme me qëllimi të krijimit të kushteve për funksionim më efektiv si rregullator ekonomik i pavarur. Me këto dokumente janë definuar më qartë aspekte të caktuara të funksionimit të brendshëm të ZRRUM dhe poashtu për ekzekutimin e përgjegjësi të tij në raport me kompanitë e licencuara.

Kështu, në kontekst të kompletimit të rregullave dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet në lidhje me organizimin e brendshëm, ZRRUM në vitin 2008 ka miratuar dokumentet vijuese:

- Kodin e Punës
- Manualin e Sigurimit të Kualitetit për Zbatimin e Politikave dhe Procedurave të Brendshme Administrative
- Strategjinë e Komunikimit me Media

Në anën tjetër, poashtu në vitin 2008, ZRRUM ka hartuar disa dokumente me rëndësi për ngritjen e cilësisë së procesit rregullator, si:

- Procedurat Rregullatore për Përcaktimin e Tarifave të Ujit dhe Ujërave të Zeza
- Udhëzime për Obligimet Raportuese të Kompanive të Licencuara
- Procedurat për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit 2009-2011
- Udhëzime për Hartimin e Planeve të Biznesit nga Kompanitë e Licencuara
- Udhëzime për Obligimet Raportuese të Kompanive të Licencuara
- Udhëzime për Kontabilitetin Rregullator të Kompanive të Ujit
- Udhëzime për Procesin e Auditimit të Kompanive të Licencuara

Të gjitha këto dokumente janë hartuar në funksion të avansimit të organizimit të brendshëm të ZRRUM dhe në funksion të avansimit të procesit rregullator që zbaton

ZRRUM. Të njëjtat dokumente ZRRUM do ti rishikojë dhe plotësojë vazhdimisht në frymën e përvojave që dalin gjatë zbatimit të tyre si dhe në pajtim me zhvillimet që ndodhin gjatë kohës.

Këto dokumente u janë shpërndarë ndërmarrjeve të licencuara si dhe janë publikuar në web-faqen e ZRRUM: www.wwro-ks.org.

5.2. STATUSI FINANCIAR I ZRRUM

Me Rregulloren 2004/49 dhe amendamentimin e saj me Ligjin Nr. 03/L-086, parashihet në mënyrë implicite që financimi i ZRRUM të bëhet nga taksat e licencimit që i paguajnë kompanitë e licencuara tek ZRRUM. Kjo formë konsiderohet si forma më e përshtatshme për financimin e rregullatorëve ekonomik (meqenëse nuk parqet ngarkesë për buxhetin qendror të shtetit) dhe është praktikë pothuajse standarde në shumicën e vendeve ku zbatohet regjimi i rregullimit ekonomik për shërbime të caktuara publike. Një formë e tillë e financimit është paraparë edhe për Zyrën Rregullatore të Energjisë (ZRRE).

Deri në vitin e kaluar, ZRRUM është trajtuar si organizatat tjera buxheore të cilat financohen prej buxhetit të konsoliduar të Kosovës(BKK) pavarësisht statusit të tij si rregullator i pavarur që financohet nga taksat e licencimit dhe pavarësisht faktit se ZRRUM ka inkasuar taksat e licencimit. Kjo ka qenë në kundërshtim me parimet e pavarësisë rregullatore duke afektuar pavarësinë financiare si parakusht bazik për pavarësinë rregullatore. Kufizimet buxhetore të cilave iu është nënshtruar ZRRUM, posaqërisht në lidhje me lartësinë e pagave të stafit, kanë shkaktuar pozitë të pavaforshme të ZRRUM në raport me kompanitë e licencuara, për arsye se pagat e stafit të ZRRUM kanë qenë disa herë më të vogla se sa të stafit të kompanive publike të ujit dhe mbeturinave. Kjo ka qenë arsye për largimin permanent të stafit të ZRRUM që ka shkaktuar vështirësi praktike në funksionimin e ZRRUM.

PAVARËSIA FINANCIARE SI PARAKUSHT PËR PAVARËSINË RREGULLATORE TË ZRRUM

Me transferimin e përgjegjësisë për ZRRUM tek Kuvendi i Kosovës, dhe me ndryshimet e bëra në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, në vitin 2008, buxheti i ZRRUM për vitin 2009 për herë të parë është shqyrtuar dhe aprovuar nga Kuvendi i Kosovës përmes procesit të dëgjimeve buxhetore të zhvilluara nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa. Me këtë është shënuar një avansim kualitativ lidhur me statusin financiar të ZRRUM në funksion të pavarësisë operative.

Përforcimi i pavarësisë financiare dhe operative të ZRRUM, përpos që është garantuar me Kushtetutë (neni 142.2 i Kushtetutës përcakton se “agjencitë e pavarura e kanë buxhetin e vet që duhet të administrohet në mënyrë të pavarur në pajtim me ligjin”), poashtu është edhe një prej prioriteteve të Qeverisë së Kosovës të adoptuar me Planin për Veprim të Partnetitet European (PVPE) sipas rekomandimeve të Komisionit European. Prandaj, ZRRUM shpreson se në frymën e këtyre dokumenteve dhe legjislacionit në fuqi, në vitin 2009 pavarësia operative dhe financiare e ZRRUM do të jetësohet në tërësi në pajtim me kornizën ligjore dhe se problemet e deritashme në këtë plan do të tejkalohen. Kjo është e absolutisht domosdoshme për funksionimin e ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator që ekzekuton përgjegjësitë ligjore me standarde të larta profesionale.

5.3. MBËSHTETJA FINANCIARE NGA DONATORËT

ZRRUM ka ndërtuar raporte të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me të gjitha institucionet donatore në Kosovë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2008, ZRRUM ka përfituar nga dy projekte në formë të asistencës teknike të financuara nga donatorët.

(i) **Projekti i parë**, i quajtur Mbështetja Institucionale për ZRRUM, i financuar nga Agjencia Europiane për Rindërtim (AER) ka filluar në Shtator 2006 dhe ka përfunduar në Shtator 2008. Ky projekt i ka ofruar mbështetje ZRRUM në formë të ekspertizës profesionale nga ekspertët ndërkombëtar në fushat vijuese:

- avansimi i metodologjisë tarifore dhe përcaktimi i tarifave,
- menaxhimi financiar,
- mbështetje e përgjithshme në zbatimin e procesit rregullator, si dhe
- në menaxhimin e mbeturinave.

Projekti është implementuar nga kompania konsulente dhe ka konsistuar në 3 ekspete kyq (udhëheqësi i projektit, eksperti për tarifa, dhe eksperti për mbeturina) dhe në disa ekspertë me angazhim të kohëpaskohshëm në fusha të ndryshme si (menaxhimi i aseteve, kontabilitetit rregullator, relacionet me publikun, menaxhimi financiar etj.).

Një komponentë e rëndësishme e projektit ka qenë edhe trajnimi i stafit të ZRRUM dhe ndërmarrja e 2 udhëtimeve studimore (në Portugali dhe në Skotlandë). Bashkëpunimi i ZRRUM me AER-in dhe me kompaninë konsulente ka qenë i shkëlqyeshëm dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi treparit projekti është vlerësuar si shumë i suksesshëm dhe shumë i dobishëm për ZRRUM. Faza përfundimtare e projektit ka koiciduar me transferimin e përgjegjësi nga AER (për shkak të shuarjes së kësaj agjencie në Kosovë) me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit European (ECLO). ZRRUM ka krijuar relacione të mira bashkëpunimi edhe me ECLO dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi, ZRRUM ka aplikuar për mbështetje shtesë nga ECLO në kuadër të programit IPA 2009, aplikacion ky që ka gjasa të aprovohet dhe të vazhdojë me përkrahje të mëtejme të ZRRUM nga Komisioni European.

(ii) **Projekti i dytë**, i quajtur Projekti për Monitorimin e Performancës së Kompanive të Ujit, ka filluar në janar 2008 dhe parashihet të përfundojë në fund të vitit 2009. Ky projekt financohet nga Zyra Zvicërene për Bashkëpunim ("Swiss Cooperation Office – SCO") dhe konsiston nga një ekspert vendor me orar të plotë që i ofron mbështetje ZRRUM në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e performancës së kompanive të ujit. ZRRUM e vlerëson edhe këtë projekt si shumë të suksesshëm dhe të dobishëm për ngritjen kapaciteteve të tija në avansimin e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së kompanive të ujit si një element shumë i rëndësishëm i procesit rregullator që zbaton ZRRUM.

6. Relacionet e Jashtme

6.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË

Në pajtim me orientimet strategjike të ZRRUM për bashkëpunim të hapur dhe të mirëfilltë me të gjitha palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë, e me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për arritjen e përmirësimeve të nevojshme në këta sektorë, ZRRUM edhe në vitin 2008 ka vazhduar qasjen e tij të hapur dhe bashkëpunuese me rregullatorët tjerë të këtyre sektorëve si dhe me palët tjera të interesit.

(i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në fushën e monitorimit të standardeve të kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

Përpos takimit të rregulltë vjetor që kemi pasur në muajin Shkurt, bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e rregulltë të informacioneve me interes të dy palëve. Në këtë plan, në Raportin Vjetor të Performancës 2007 për kompanitë e ujësjellësit, ZRRUM ka shfrytëzuar të dhënat e IKSHPK. Rrjedhimisht, në bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK (si dhe MMPH, SHUKOS, donatorët) kemi shpallur kompaninë më të mirë të ujësjellësit për vitin 2007 dhe kemi organizuar ceremoninë e ndarjes së çmimeve në muajin Gusht 2008. ZRRUM është i përkushtuar që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

(ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë dhe si rregullator mjedisor i sektorit të ujit dhe mbeturinave, ZRRUM edhe gjatë vitit 2008 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH në sektorët e ujit dhe mbeturinave.

Për më tepër relacionet me MMPH kanë shënuar një ngritje në kuptim të takimeve të rregullta dhe në kuptim të pjesëmarrjes së ndërsjellë në takimet punuese apo workshopet që ka organizuar ZRRUM respektivisht MMPH. Drejtori i ZRRUM ka pasur disa takime personale me Ministrin e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave dhe në veqanti atë mbeturinave dhe me këtë rast janë diskutuar edhe çështjet që lidhen me harmonizimin e legjislacionit në këta sektorë me qëllim të përcaktimit të qartë të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

ZRRUM ka marrë pjesë aktive në të gjitha workshopet e rëndësishme që ka organizuar MMPH gjatë vitit 2008, qoftë në lidhje me sektorin e ujit (workshopi për strategjinë e investimeve, workshopi për pellgjet lumore etj.) poashtu edhe në lidhje me sektorin e mbeturinave (takimet punuese për iniciimin e hartimit të planit strategjik etj.). ZRRUM edhe në lidhje me MMPH është fuqimisht i përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në interes të koordinimit të veprimeve për progresin e sektorit të ujërave dhe mbeturinave.

(iii) Bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MEF

Duke qenëse AKM ka pasur rolin e autoritetit që ushtron mbikqyrjen në emër të pronarit të kompanive publike të ujit dhe mbeturinave, deri në shuarjen e saj në qeshor 2008, ZRRUM ka bashkëpunuar ngushtë me të në ushtrimin e funksioneve rregullatore mbi këto kompani.

Pas shuarjes së AKM, dhe marrjes së përgjegjësisë të saj nga MEF, respektivisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) e MEF-it, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt. Kështu përpos një takimi inicial me NJPM në Gusht të 2008, ZRRUM ka pasur edhe 2 takime tjera me MEF-in në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e deponive sanitare të menaxhuara nga KLMC si ndërmarrje publike qendrore.

Duhet të theksohet këtu se një problem real që është manifestuar pas shuarjes së AKM-së, ka qenë vonesa e konstituimit të Bordeve të Drejtorëve në ndërmarrjet publike të ujit dhe mbeturinave të cilat deri në momentin e përpilimit të këtij raporti nuk janë funksionalizuar ende. ZRRUM shpreson se këto Borda do të funksionalizohen së shpejti me çka do të eliminohej vakkumi aktual në mbikqyrjen e këtyre ndërmarrjeve.

(iv) Bashkëpunimi me Shoqatën e Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit (SHUKOS)

Bashkëpunimi me kompanitë e licencuara të ujit dhe kanalizimit në mënyrë të drejtpërdrejt si dhe përmes SHUKOS-it ka vazhduar edhe në vitin 2008. Në këtë plan, ZRRUM ka marrë pjesë aktive në:

- Ditën Botërore të Ujit (më 22 mars 2008) të organizuar nga SHUKOS, si dhe në
- Ditët e Shërbimeve të Ujit që është ngjarje tradicionale vjetore, që kësaj radhe është organizuar në tetor 2008. Në këtë manifestim drejtori i ZRRUM ka qenë në rolin e panelistit në 2 sesione tematike të këtij evenimenti.

(v) Bashkëpunimi me Palët tjera

Në vitin 2008, ZRRUM ka bashkëpunuar edhe palët tjera të interesit në kuadër të domenit të përgjegjësisë të veta. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me:

- Agjencinë për Integritet Europian (AEI) në lidhje me hartimin e PVPE për 2008;
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM);
- Shoqatën e Kompanive të Mbeturinave (PAMKOS);
- Asociacionin e Komunave të Kosovës; dhe me
- Përfaqësuesit e donatorëve (USAID, KfW, SCO, GTZ etj.)dhe konsulentëve (Rodeco, IRD, EPTISA etj.) që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë.

Me të gjitha këto palë, qoftë në takime të drejtpërdrejta apo në punëtori dhe konferenca janë diskutuar zhvillimet në sektorët e ujit dhe mbeturinave dhe është paraqitur qëndrimi i ZRRUM lidhur me problemet aktuale në këta sektorë.

6.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EUROPË

Bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujërave ZRRUM e konsideron me rëndësi vitale për shkëmbimin e përvojave dhe për adoptimin e praktiokave të mira në fushën e zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit.

Në këtë plan, në vitin 2008, ZRRUM ka vazhduar të bashkëpunojë me rregullatorët ekonomik të shërbimeve të ujit të: Portugalisë (IRAR), Skotlandës (WICS), dhe Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i inicuar më herët.

- Vizita njëjavore studimore në Skotlandë në muajin maj 2008, ka qenë për e dobishme për stafin e ZRRUM për tu njoftuar me zhvillimet e fundit në Komisionin për Industrinë e Ujit të Skotlandës (WICS) si dhe për të shkëmbyer përvojat e ndërsjella.
- Në anën tjetër, bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë i inicuar në fund të vitit 2007, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe me shkëmbimin e Raporteve Vjetore të Performancës 2007 të Kosovës respektivisht Portugalisë.
- Dhe në fund, me Entin Rregullator të Ujit (ERRU) të Shqipërisë kemi shkëmbyer vizita reciproke gjatë vitit 2008 (ZRRUM ka qenë nikoqir i ERRU në qeshor 2008, ndërkaq ZRRUM ka vizituar ERRU në Tiranë në nëntor 2008). Në këto takime është konkluduar bashkarisht nevoja e bashkëpunimit të ngushtë të dy autoriteteve tona rregullatore dhe është deklaruar përkushtimi i vendosur për të vazhduar bashkëpunimin e fuilluar. Për këtë qëllim është arritur marrëveshje parimore që në pjesën e parë të vitit 2009 ta formalizojmë bashkëpunimin me nënshkrimin e një Memorandumi të Bashkëpunimit.

6.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

Duke pasur parasysh faktin se koncepti i rregullativës ekonomike të shërbimeve publike është koncept relativisht i ri në Kosovë dhe rrjedhimisht njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve Kosovare dhe publikut të gjërë për këtë koncept janë mjaft të kufizuara, ZRRUM në vitin 2008 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjërë për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUM.

Në këtë kontekst, me qëllim të krijimit të një qasjeje më të strukturuar dhe më sistematike të komunikimit me palët tjera të interesit dhe me konsumatorët e shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave, ZRRUM në vitin 2008 ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë e Komunikimit që do ti shërbejë si kornizë për komunikimin efektiv për të gjitha aspektet e punës dhe vendimet rregullatore që lidhen me veprimtarinë e ZRRUM.

Aktivitetet konkrete që ka zhvilluar ZRRUM në vitin 2008 në kontekstin e relacioneve me publikun mund të përmbledhen në sa vijon:

- Drejtori i ZRRUM ka pasur disa paraqitje në TV dhe radio-stacionet nacionale ku ka prezantuar pikëmajet e ZRRUM për zhvillimet në sektorin e ujit dhe mbeturinave dhe për çështje të veçanta si: aktivitetet e ZRRUM për promovimin e interesave të konsumatorëve, vlerësimin e performancës së kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave, etj.);
- Në Nëntor 2008, ZRRUM ka publikuar një broshurë (fletëpalosje) në të cilën janë përshkruar funksionet e ZRRUM me theks të veçantë në rolin që ka ZRRUM për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Në këtë broshurë, e cila është shpërndarë tek të gjithë konsumatorët bashkë me faturat e ujit nga kompanitë e ujësjellësit, janë dhënë detaje për mekanizmat dhe procedurat të cilat konsumatorët i kanë në dispozicion për tu ankuar;
- Në Dhjetor 2008, ZRRUM ka realizuar një Sondazh për Hulumtimin e Opinioneve të Konsumatorëve të Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Mbeturinave i cili është zhvilluar në bashkëpunim me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) në 7 regjionet e Kosovës. Raporti i hartuar si rezultat i këtij sondazhi ka paraqitur opinionet e konsumatorëve lidhur me: lartësinë e tarifave, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave, nivelin e njohurive të konsumatorëve me ekzistencën dhe rolin e ZRRUM dhe të KKK-ve etj.

- Në qershor 2008, ZRRUM ka kompletuar dhe publikuar Raportin Vjetor të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave për vitin 2007, i cili raport iu është shpërndarë të gjitha palëve të interesit si dhe medieve elektronike dhe të shkruara;
- Në takimet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve të cilat mbahen në 7 regjionet e Kosovës ku ofrojnë shërbimet e tyre kompanitë publike të ujësjellësit dhe kanalizimit janë ftuar (dhe në disa raste kanë marrë pjesë) televizionet lokale të cilat kanë përcjellë dhe transmetuar punën e këtyre komisioneve.

7. Sfidat dhe Perspektiva për Vitin 2009

7.1. PROBLEMET ME TË CILAT ËSHTË PËRBALLUR ZRRUM NË 2008

Gjatë vitit 2008, ZRRUM është përballuar me disa rrethana kufizuese, që realisht kanë qenë jashtë kontrollit të ZRRUM, e të cilat kanë ndikuar negativisht në efektivitetin e punës së tij.

(i) Vonesa në emërimin e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit

Me Ligjin Nr.03/L-086 është përcaktuar që Drejtori dhe Zëvendësdrejtori i ZRRUM emërohen nga Kuvendi i Kosovës me rekomandim të Qeverisë. Mandati i Drejtorit ka skaduar në fund të qershorit të vitit 2008, dhe procedura e inicuar nga UNMIK për zgjatjen e mandatit të tij edhe për një vit nuk është përfunduar në ndërkohë. Prandaj drejtori i ZRRUM vazhdon të ekzekutojë funksionin dhe detyrat e menaxhimit të ZRRUM pa pasur një emërim formal për një gjë të tillë. Edhe përkundër kërkesës me shkrim dërguar nga ana e ZRRUM Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, deri në përfundimin e këtij raporti (mars 2009) kjo çështje ka mbetur e pazgjidhur.

(ii) Pengesat e shfaqura për funksionimin e ZRRUM si autoritet financiarisht i pavarur

Përkundër faktit se ZRRUM prej vitit 2006 grumbullon taksat e licencimit nga kompanitë publike të licencuara në pajtim me Rregulloren 2004/49, të hyra këto të dedikuara për financimin e veprimtarisë së ZRRUM, edhe në vitin 2008 ZRRUM ka vazhduar të trajtohet si organizatat tjera buxhetore duke iu nënshtruar kufizimeve buxhetore. Ky trajtim i ZRRUM si organizatë buxhetore që financohet nga buxheti i Kosovës konsiderohet nga ZRRUM si forma joadekuate, madje në kundërshtim me parimet e pavarësisë rregullatore (duke qenë pavarësia financiare parakusht fundamental për pavarësinë operative). Kjo ka afektuar funksionimin e ZRRUM duke rezultuar me paga të ulëta të stafit të cilat kanë qenë shumë më të vogla se sa pagat e stafit të kompanive publike që i rregullon ZRRUM. Për pasojë ZRRUM është ballafaquar me problemin kronik të largimit permanent të stafit për arsye të pagave (më shumë se dhjetë punëtorë janë larguar prej vitit 2006) duke humbur kështu kapacitetet profesionale në të cilat janë bërë investime të konsiderueshme. Problemi është veçanërisht i theksuar kur të kihet parasysh fakti se rregullativa ekonomike e shërbimeve publike është koncept relativisht i ri në Kosovë që ka për pasojë ekspertizën e limituar profesionale në këtë fushë.

Problemet e lidhura me statusin financiar të ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator që i jep llogari Kuvendit të Kosovës, shpresoj të tejkalohen në 2009, meqenëse në buxhetin e ZRRUM për vitin 2009 i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, janë marrë parasysh kërkesat buxhetore të ZRRUM për domosdoshmërinë që pagat e stafit të ZRRUM të jenë të krahasueshme me ato të kompanive publike të cilat i rregullon ZRRUM. Megjithatë deri në muajin mars 2009 nuk janë eliminuar pengesat procedurale/administrative për ekzekutimin e buxhetit të ZRRUM në lartësinë që e ka aprovuar Kuvendi i Kosovës, përkundër angazhimit intensiv të ZRRUM që ky problem të zgjidhet përfundimisht në pajtim me të gjitha aktet juridike në fuqi si: Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për ZRRUM, dhe Ligji për Buxhetin 2009.

(iii) Paqartësitë lidhur me rolin dhe përgjegjësitë në sektorin e mbeturinave

Ligji për Mbeturinat (nr. 02/L-030) i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, përveç tjerash përcakton se MMPH është autoritet përgjegjës për **licencimin** e personave juridik që menaxhojnë mbeturinat. Kjo bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit licencimi i ofruesve të shërbimeve të mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM. Komunitat në anën tjetër sipas Ligjit për Mbeturina janë përgjegjëse për administrimin e mbeturinave në territorin e vet dhe për **përcaktimin e tarifave** për shërbimet e mbeturinave. Edhe kjo përgjegjësi e komunave bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-086 sipas të cilit përcaktimi i tarifave për shërbimet e mbeturinave është përgjegjësi e ZRRUM.

Këto kundërtënie janë eliminuar në një masë me Rregulloren 2006/31 me të cilën është dekretuar Ligji për Mbeturinat dhe e cila e ka konfirmuar përgjegjësinë e ZRRUM për rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të mbeturinave.

Megjithatë, në praktikë, kjo përzierje e kompetencave, ka lënë hapsirë për ambiguitet në interpretim dhe paqartësi. Për pasojë ka ndikuar negativisht në performancën e sektorit të mbeturinave si dhe ka penguar që detyrat dhe përgjegjësitë institucionale të palëve të ndryshme të adresohen qartë. Konkretisht, MMPH duke u thirrë në Ligjin për Mbeturina ka licencuar disa kompani private (për opinionin e ZRRUM pa mbështetje të duhur ligjore) të cilët kanë ofruar shërbime për konsumatorë që janë pagues të mirë (KFOR, institucione publike etj.), duke shkaktuar kështu vështirësi shtesë financiare për kompanitë regjionale të mbeturinave.

Me qëllim të eliminimit të këtyre problemeve ZRRUM ka inicuar amendamentimin e Ligjit nr. 03/L-086, me të cilat amendamente do të largoheshin përgjegjësitë e ZRRUM në sektorin e mbeturinave dhe do të mundësohej zbatimi i Ligjit për Mbeturinat. Me këtë poashtu do të mundësohej futja e konkurrencës në shërbimet e mbeturinave në rast se komunitat vendosin të bëjnë një gjë të tillë në interes të ngritjes së efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve.

(iv) Mungesa e politikave dhe planeve strategjike nacionale për ujë dhe mbeturina

Fatkeqësisht, në Kosovë nuk kemi të përcaktuara qartë politikat nacionale për sektorin e ujit dhe mbeturinave. Këto politika mund të inferohen nga legjislacioni aktual që rregullon fushën e menaxhimit të ujërave dhe mbeturinave, megjithatë përmbledhja e qartë politikave qeveritare në formën e një dokumenti të zhvilluar për sektorin e ujit respektivisht për sektorin e mbeturinave do të krijonte vizionin për zhvillimin e këtyre sektorëve. Poashtu, në bazë të politikave të deklaruara qartë do të zhvillohej mëtutje dhe do të harmonizohej legjislacioni si instrument që krijon mjedisin për zbatimin e politikave.

Në anën tjetër, qeveria e Kosovës ende nuk ka hartuar planet nacionale strategjike për sektorët e ujit dhe mbeturinave me qëllim të përcaktimit të strategjisë 5-10 vjeçare për zbatimin e politikave të përcaktuara. Çështja e zgjerimit të shërbimeve në zonat rurale dhe synimet specifike në këtë plan, pastaj çështja e konsumatorëve të varfër, çështja e trajtimit të ujërave të zeza, etj. do të duhej sqaruar me planin strategjik.

Mungesa e politikave dhe strategjisë së qeverisë në fushën e ujërave dhe mbeturinave, paraqet hendikep për zhvillimin e këtyre sektorëve dhe poashtu edhe për punën e ZRRUM. Kjo për faktin se, me politika dhe strategji qeveritare do të definohej korniza e investimeve të nevojshme që do të i mundësonte ZRRUM zhvillimin e procesit rregullator në pajtim me objektivat strategjik qeveritar.

Një zhvillim pozitiv në drejtim të hartimit të politikave dhe strategjisë qeveritare pritet të ndodhë në vitin 2009, meqenëse MMPH ka inicuar në fund të vitit 2008 punën në hartimin e planit strategjik nacional të mbeturinave. Poashtu, në sektorin e ujërave pritet që në vitin 2009 të fillojë një projekt i financuar nga Zyra Zvicrane (SCO), që do ta mbështesë qeverinë e Kosovës në zhvillimin e politikave për sektorin e ujërave përmes krijimit të një ‘task force’ e cila do të krijohet për këtë qëllim.

7.2. SYNIMET STRATEGJIKE TË ZRRUM NË VITIN 2009

Me qëllim të realizimit të përgjegjësisë të veta ligjore si dhe synimeve strategjike, ZRRUM ka përcaktuar synimet operative për vitin 2009 të cilat ZRRUM do të angazhohet ti përmbushë në këtë vit:

- Përforcimi i pavarësisë financiare dhe operative me mandat të përcaktuar qartë;
- Ngritja e profilit të ZRRUM si akter kyç në zhvillimin e sektorit të ujit;
- Avansimi i mëtutjeshëm i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së kompanive të ujit me qëllim të ngritjes së transparencës dhe stimulimit të konkurrencës;
- Ngritja e nivelit të pajtueshmërisë së kompanive të licencuara me standardet e shërbimeve të përcaktuara me kornizën rregullatore;
- Avansimi i mëtutjeshëm i metodologjisë tarifore me qëllim të stimulimit të efikasitetit dhe investimeve kapitale në sektorin e ujit;
- Konsolidimi i mekanizmave për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve; dhe
- Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik në Kosovë dhe Europë si dhe me palët tjera të interesit.

Për secilin prej synimeve të mësipërme, ZRRUM ka përcaktuar një sërë veprimesh konkrete të cilat do të ndërmerren dhe në bazë të së cilave do të vlerësohet performansa e ZRRUM. Synimet operative si dhe përshkrimi i aktiviteteve specifike për arritjen e synimeve operative të ZRRUM për vitin 2009, janë përshkruar në hollësi në Planin e Veprimit të ZRRUM për 2009 i cili i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës në Jnanar 2009.

8. Aspektet Financiar

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUM janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kriterëve vijuese:

- të hyrat nga këto taksa duhet të korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUM për vitin respektiv, me kusht që
- lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Në rast të problemeve që eventualisht do të paraqiteshin në arkëtimin e taksës së licencimit nga kompanitë e licencuara, ZRRUM ka të drejtë të kërkojë mjete nga buxheti i Kosovës në pajtim me Ligjin për Buxhetin e Kosovës 2009, për të mos u rrezikuar funksionimi i tij.

Poashtu, projekte dhe aktivitete të caktuara të ZRRUM mund të financohen nga donacionet e agjencive donatore si dhe nga grantet qeveritare.

Buxheti vjetor i ZRRUM aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e parashikimit të shpenzimeve të veta ZRRUM udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të mos këtë kosto të lartë për konsumatorët.

8.1. SHPENZIMET

Edhe pse, ZRRUM të gjitha transaksionet financiare i kryen përmes sistemit të Thesarit, që për pasojë ka mbajtjen e kontabilitetit financiar të ZRRUM nga Thesari (sikurse edhe për të gjitha organizatat tjera buxhetore), megjithatë ZRRUM mban kontabilitetin e vet financiar dhe material dhe për çdo tre muaj bën barazimin me departamentin e Thesarit.

Për vitin fiskal 2008, ZRRUM ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 261,397.00 EUR, prej të cilave: 222,837.00 EUR të alokuara nga BKK dhe 38,542.00 EUR të hyra vetanake të bartura nga viti 2007.


Në tabelën mëposhtë (Tabela 5) është dhënë një pasyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUM në vitin fiskal 2008 si dhe shpenzimeve të realizuara.

Tabela 4: Buxheti i ZRRUM për 2008

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	94,168.00	81,655.06
Mallëra dhe shërbime	157,861.00	134,979.75
Nga BKK	119,319.00	117,209.63
Nga të Hyrat Vetanake	38,542.00	17,763.12
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	9,350.00	4,448.90
Total Buxheti	261,379.00	221,086.71

Në formë grafikoni, vlera dhe përqindjet e shpenzimeve të ZRRUM për kategoritë e ndryshme janë paraqitur në Figurën 11.

Figura 11: Struktura e shpenzimeve të ZRRUM në 2008



Specifikimi i detajuar i llojit të shpenzimeve sipas kategorive është paraqitur në tabelën vijuese (Tabela 6).

Tabela 6: Pasqyra detaje e shpenzimeve të ZRRUM në 2008

Nr.	Kategoria dhe Lloji i Shpenzimeve	Vlera (EUR)
I	Paga dhe Mëditje (18 punëtorë)	81,655.06
II	Mallëra dhe Shërbime	132,387.55
	Furnizime (pajisje të TI-së, inventar dhe material harxhues)	29,088.30
	Furnizim me karburant për vetura	4,784.65
	Furnizim me derivate për ngrohje qendrore	3,601.00
	Furnizim me derivate për gjenerator	1,186.90
	Shërbime (rikonfigurimi i ueb faqes përkthime etj.)	7,242.15
	Publikime (Raporti i broshurës, publikimi i brochures etj.)	10,139.92
	Shpalljet dhe konkurset	3,392.25
	Pagesa për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve	10,102.49
	Qiraja e objektit	42,000.00
	Sigurimi i Objektit	10,379.87
	Udhëtime studimore jashtë vendit 11 persona 5 ditë	1,738.00
	Mëditje udhëtim jashtë vendit 11 persona 5 ditë	1,989.20
	Trajnime	604.50
	Reprezentacion 388.6 + 445 darka e fund vitit	833.60
	Regjistrimi dhe mirëmbajtja e veturave (5 vetura)	1,373.65
	Riparimet e veturave	1,589.51
	Shërbimet e Internetit	2,341.56
III	Shpenzimet Komunale Total	4,448.90
	Shpenzimet e Energjisë Elektrike	2,576.05
	Shpenzimet e Ujës-jellës	229.63
	Shpenzimet e Telefonisë	1,548.22
	Shpenzimet e Mbeturinave	95.00
	Total	221,086.71

8.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT

Duhet të theksohet se përpos këtyre mjeteve, ZRRUM në vitin 2008 ka pasur mbështetje insitucionale nga donatorët (AER/ECLO, SCO) në formën e asistencës teknike në vlerë rreth 400,000 EUR (të dhënat e sakta financiare ZRRUM nuk i posedon meqenëse menaxhimi financiar i projekteve është bërë nga vet donatorët).

8.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT

Për vitin 2008, ZRRUM ka faturuar kompanive të licencuara të ujit dhe mbeturinave në emër të taksës së licencimit vlerën totale prej: **302,906.14 EUR**.

Përderisa pagesa e taksës së licencimit nga ana e kompanive të ujit ka qenë më e mirë (85.8%), kompanitë e mbeturinave me pretekstin e vështirësive financiare, në përgjithësi kanë pasur një shkallë shumë të ulët të pagesës (vetëm 13%), duke mos përmbushur obligimet e tyre ndaj ZRRUM të përcaktuara me ligj. Edhe pse ZRRUM ka të drejtë të revokojë licencën e shërbimit në rast mospagese të taksës së licencimit, ZRRUM nuk e ka ndërmarrë deri tashti një veprim të tillë. Me konsituimin e Bordeve të këtyre ndërmarrjeve dhe me qartësimin e statusit pronësor të tyre, ZRRUM konsideron se janë krijuar kushte më të volitshme për përmirësimin e shkallës së pagesës së kompanive të licencuara (në veçanti të atyre të mbeturinave) të taksës së licencimit.

(i) Të hyrat e Realizuara nga Kompanitë e Ujit

Në vitin 2008, ZRRUM ka faturuar për kompanitë e ujit në total: **202,399.54 EUR**. Prej kësaj shume janë arkëtuar gjithësej: **173,610 EUR**.

Tabela 7: Pagesa e Taksës së Licencimit nga Kompanitë e Ujit

Emri i Kompanisë	Taksa Vjetore	Taksa Mujore	Të Paguara në 2008 për 2007	Të paguara për 2008	Total të Paguara 2008
KRU "RADONIQI" Gjakovë	22,607.12	1,883.93	4,118.80	15,071.44	19,190.24
KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" Prizren	20,467.26	1,705.61	9,500.08	17,725.91	27,225.99
KRU "MITROVICA" Mitrovicë	24,492.41	2,041.03	3,561.62	24,492.44	28,054.06
KRU "BIFURKACIONI" Ferizaj	7,899.49	658.29	4,283.41	9,216.06	13,499.47
KRU "PRISHTINA" Prishtinë	87,379.60	7,281.63		72,816.30	72,816.30
KRU "HIDRODRINI" Pejë	24,906.72	2,075.56		24,906.72	24,906.72
KRU "HIDROMORAVA" Gjiilan	12,071.31	1,005.94		7,041.70	7,041.70
KHE "IBER-LEPENCI" Prishtinë	2,575.63	214.64		2,575.68	2,575.68
Totali:	202,399.54	16,866.63	21,463.91	173,846.25	195,310.16

Nga pasqyra e mësipërme mund të shihet se pagesën e rregulltë dhe të plotë të taksës së licencimit e kanë kryer:

- KHE "Ibër-Lepenci" Prishtinë,
- KUR Hidrodrini" Pejë,
- KUR "Bifurkacioni" Ferizaj, dhe
- KUR "Mitrovica" Mitrovicë.

Ndërkaq, kompanitë të cilat nuk kanë kryer obligimet e tyre ligjore të pagesës së plotë të taksës së licencimit janë:

- KUR "Prishtina" Prishtinë (84%),

- KUR “Radoniqi” Gjakovë (67%), dhe
- Në veçanti KUR “Hidromorava” Gjilan (59%).

(ii) Të hyrat e Realizuara nga Kompanitë e Mbeturinave

Në vitin 2008, ZRRUM ka faturuar për kompanitë e mbeturinave në total: 100,506.60 EUR. Prej kësaj shume janë arkëtuar vetëm: 13,065.96 EUR.

Tabela 7: Pagesa e Taksës së Licencimit nga Kompanitë e Mbeturinave

Emri i Kompanisë	Taksa Vjetore	Taksa Mujore	Të Paguara në 2008 për 2007	Të paguara për 2008	Total të Paguara 2008
KRM “HIGJENA” Gjilan	10,545.35	878.78		7,909.02	7,909.02
KRM “EKOREGJIONI” Prizren	15,898.18	1,324.85		0.00	0.00
KRM “PASTRIMI” Prishtinë	32,190.76	2,682.56		0.00	0.00
KRM “AMBIENTI” Pejë	8,758.35	729.86		0.00	0.00
KRM “UNITETI” Mitrovicë	10,906.90	908.91		1,817.82	1,817.82
KRM “PASTËRTIA” Ferizaj	9,772.50	814.37	1,788.08	0.00	1,788.08
Kompania për Menaxhimin e Deponive “KLMC” Prishtinë	6,314.70	526.23	1,551.04	0.00	1,551.04
KRM “ÇABRATI” Gjakovë	6,119.86	509.99		0.00	0.00
Totali:	100,506.60	8,375.55	3,339.12	9,726.84	13,065.96

Nga Tabela e mësipërme mund të shihet se pagesën më të rregulltë të taksës së licencimit nga kompanitë e mbeturinave e ka kryer KRM “Higjiena” Gjilan (75%). Në një masë të vogël pagesën e kanë kryer edhe KLMC (25%), “Pastërtia” Ferizaj (19%) dhe “Uniteti” Mitrovicë (17%).

Në anën tjetër, “Pastrimi” Prishtinë, “Ambienti” Pejë, “Çabрати” Gjakovë dhe “Ekoregjioni” Prizren nuk kanë kryer asnjë pagesë të vetme në emër të taksës së licencimit. ZRRUM do të tentojë që në bashkëpunim institucional me Bordet e këtyre kompanive të adresojë problemin e pagesës së taksës së licencimit, dhe në rast se nuk arrihet ndonjë efekt nga kjo, atëherë ZRRUM do të konsideroj seriozisht revokimin e licencës së shërbimit për këto kompani.

8.4. ASETET E ZRRUM

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, pastaj Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetëm e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve në ZRRUM që nga viti 2005 e deri me 31.12.2008 ka arritur në: 96,582.00 EUR.

Nr.	Lloji i Aseteve	Vlera e Aseteve
1	Vetura	74,012.00€
2	Inventar, Pajisje, TI etj.	22,570.00€
Total:		96,582.00€